

A L B A N I A N

BASIC COURSE

Basic Situations

June 1970

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE  
FOREIGN LANGUAGE CENTER



## PREFACE

The purpose of this volume is to provide the student with a vehicle for reviewing the grammar and vocabulary of Lessons 1-120 of the Basic Course and, with practice and the help of new words and idioms, increase his fluency and scope of expression.

The volume contains eleven "situations," numbered A to K, each divided into five sub-situations. Each sub-situation consists of cartoons, a short description for each frame of the cartoons, and a glossary. The student's task is to enlarge the short descriptions in a homework assignment, and present his work orally and in writing the next morning. Through appropriate questions and answers, the instructor will lead the student to free conversation.

Because of the review and free development aspects of the volume, it is introduced in the final phase of the course for one hour each day.

All inquiries concerning these materials, including requests for authorization to reproduce, should be addressed to the Director, Defense Language Institute, U.S. Naval Station, Anacostia Annex, Washington, D.C. 20390.



## TABLE OF CONTENTS

	Page
A First Activities in the Morning	1
B Moving About the City	13
C A Visit from Friends	25
D A Meal at Home	37
E A Trip by Train	49
F A Trip Abroad	61
G A Medical Checkup and Parts of the Body	73
H Buying Things	85
I Dealing with People	97
J Farming and the Seasons	109
K Crime and Punishment	121



## Pjesa A




A-1 Mëngjesi - Ngrihem nga krevati.

A-2 Në banjë.

A-3 Në banjë (vazhdim).

A-4 Duke u-veshur.

A-5 Ha mëngjes.











Mëngjesi - Ngrihem nga krevati

0. Në komodin pranë shtratit kam një llambë elektrike dhe sahatin me zile. Në orën shtatë të mëngjesit bie zilja e sahatit. Menjëherë më del gjumi, por zakonisht nuk luaj nga vendi për pak kohë. Nga dritarja shihet duke lindur dielli.
1. Pas pak minutash çohem dhe qëndroj ulur në krevat duke mbështetur shpinën dhe kokën në jastëk. Më hapet goja (gogësisj).
2. Për të më dalur gjumi edhe më mirë, shtrihem. Këtë gjë e bëj pothuaj çdo mëngjes pasi zgjohem.
3. Pastaj heq mbulesat dhe filloj të dal nga krevati; ve këmbën e majtë dhe pastaj të djathtën mbi qilim që gjendet mbi dysHEME pranë shtratit,
4. vesh papuçet (pantoflat) duke qëndruar ulur në anë të krevatit dhe pastaj ngrihem më këmbë dhe
5. vete pranë raftit. Xhvesh xhaketën e pixhamës e plaçkat tjera një nga një dhe ja i var në raft ja i lë mbi karrigë.
6. Vesh "rrob-de-shamberin" dhe lidh rrypin e bëhem gati në këtë mënyrë të vete e të bëj banjë.

Fjalor

llambë, -a  
për të (më, etc.) dalë gjumi  
për t'u-hapur goja  
për të gogësitur  
mbulesa, -t  
qilim, -i  
papuçe, -t  
pantofla, -t  
për të xhveshur  
pixhamë, -a, pixhama, -t  
rrob-de-shamber, -i

see "llampë"  
to wake up  
to yawn  
to yawn  
covers  
see "qylym"  
slippers  
slippers  
to take off (clothes)  
pajamas  
robe




Në banjë

0. Çdo mëngjes, pasi marr peshqirin, vete në banjë për të bërë një dush ose për t'u-larë në vaskë. Pasi xhvishem bëj banjë.
1. Sot dua të lahem në vaskë, prandaj porsa hyj në banjë hap rubinetin e ujit të nxehtë që të mbush vaskën, por jo aq shumë sa të derdhet.
2. Duke u-mbështetur në mur që të mos rrëzohem, fut këmbën e majtë në vaskë për të provuar temperaturën e ujit.
3. Pasi uji është shumë i nxehtë më djeg këmbën, kështu që detyrohem t'a nxjerr menjëherë.
4. Për t'a bërë ujin të vakët hap rubinetin e ujit të ftohët gjer sa uji në vaskë të jetë i përshtatshëm për t'u-larë në të.
5. Hyj në vaskë dhe filloj të lahem duke përdorur një vurcë për të larë shpinën, pasi është shumë e vështirë të lash shpinën pa të.
6. Pasi mbaroj së lari dal nga vaska, marr peshqirin dhe fshihem. Pastaj marr nga varësja rob-de-shamberin dhe e vesh.

Fjalor

vaskë, -a  
për t'u-xhveshur  
rubinet, -i  
i vakët  
vurcë, -a  
për t'u-fshirë

bathtub  
see "me u-çveshë"  
see "muslluk"  
lukewarm, tepid  
see "brushë"  
to wipe oneself; to be swept;  
to be erased








Në banjë (vazhdim)

0. Çdo mëngjes, pasi bëj banjë, nxjerr nga rafti i vogël që gjendet përmbi lavaman sapunin e mjekrës, vurdën dhe briskun dhe, duke qëndruar para pasqyrës, rruhem.
1. Kur mbaroj së rruari laj fytyrën, qafën e veshët (kur nuk bëj banjë) me ujë e sapun e nganjëherë me shpuzë.
2. Pasi fshihem i ve fytyrës pak kolonjë, mbyll shishen dhe e ve në vend.
3. Laj dhëmbët me vurdën e dhëmbëve e me pastë dhëmbësh. Kur mbaroj shtie vurdën në këllëfin në saj dhe e fut në raft.
4. Pastaj marr një gotë me ujë të vakët e i hedh brenda 5-6 pika dezinfektant dhe shplaj gojën e bëj gargare me të.
5. Nganjëherë dal nga banja pa u-krehur, por zakonisht nuk harroj. Marr krëhërin dhe krihem e
6. në qoftë se flokët nuk më rrinë, atëhere i ve në vend duke përdorur një vurdë flokësh.

Fjalor

vazhdim, -i  
sapun mjekre  
mjekër, mjekra  
të rruar, -it  
shpuzë, -a  
kolonjë, -a  
pastë dhëmbësh  
dezinfektant, -i  
për të shplarë  
gargare, -t

continuation  
shaving soap  
chin; whiskers; beard  
shaving, shave  
sponge  
cologne  
toothpaste  
disinfectant  
see "me shpërlá"  
gargling








Duke u-veshur

0. Kur mbaroj së lari e së rruari, kthehem në dhomën e fjetjes, nxjerr nga rafti plaçkat, në qoftë se i kam futur atje natën përpara dhe filloj të vishem. Së pari vesh brekët dhe pastaj fanellën.
1. Nxjerr nga një sirtar i komosë një palë çorapë të pastër dhe ulem në një karrigë e i vesh.
2. Ngrihem nga karriga dhe marr nga komoja një këmishë të pastër dhe e vesh ose vesh këmishën që kisha veshur ditën më parë.
3. Zgjedh në raft një kravatë, të cilën e ve duke e lidhur. Kam mjaft kravata, por disa pothuajse nuk i ve kurrë pasi s'më pëlqejnë.
4. Pastaj vesh pantallonat, shtrëngoj dhe mbërthej tokëzën e rrypit.
5. Ulem edhe një herë në karrigë ose në anë të krevatit e mbath këpucët e mandej shtrëngoj e lidh lidhëset.
6. Në fund fare vesh xhaketën, të cilën e mbërthej e kështu jam gati të vete e të ha mëngjes në dhomën e bukës ose në kuzinë.

Fjalor

të larë, -t  
sirtar, -i  
komo, -ja  
për të mbërthyer  
tokëz, -a  
për të mbathur  
lidhëse, lidhësja

washing, wash  
see "syzë"  
dresser  
to fasten; to button  
buckle  
to put on shoes, shorts or  
socks; to shoe  
shoelaces





Ha mëngjes

0. Çdo mëngjes, para se të vete në punë, ha mëngjes. Ndërsa jam duke ngrënë mëngjes i hedh një sy gazetës së ditës për të ditur se ç'ngjan në qytetin tim, në vendin tonë e në botë në përgjithësi.
1. Në mëngjes nuk e kam zakon të ha shumë. Zakonisht, ha dy thela bukë të thekur me gjalpë e reçel e pi një ose dy filxhana kafe me qumësht.
2. Para se të filloj të ha dal e marr nga kutia e postës gazetën, që përdasi e ka lënë aty heret në mëngjes.
3. Nganjëherë, duke kënduar gazetën, padashur, bëhem vonë. Kur shikoj sahatin shoh se duhet të kisha dalur nga shtëpia së paku pesë minuta më parë.
4. Atëhere ngrihem nga karriga e me shpejtësi gëlltit kafënë që më ka mbetur në filxhan,
5. vrapoj e marr pallton e kapelën nga varësja që gjendet në koridor, i vesh menjëherë dhe
6. duke nxituar dal nga porta e shtëpisë e vete të marr autobusin që më shpie në qendër të qytetit, ku unë punoj.

Fjalor

thelë, -a  
i, e, të thekur  
bukë e thekur  
reçel, -i  
padashur  
për të gëlltitur  
për të nxituar

slice  
toasted  
toast  
jam  
unintentionally, unwillingly  
to swallow, to gulp down  
to hurry



Pjesa B







B-1 Marr autobusin.

B-2 Marr një taksi.

B-3 Dal për të bërë një shetitje.

B-4 Një shetitje jashtë qytetit.

B-5 Vazhdoj shetitjen e kthehem në shtëpi.










Marr autobusin

0. Sot në mëngjes qe një prej atyre ditëve që kur arrij ke ndalesa e autobusit, shoh se autobusi ka kaluar, por kjo nuk qëllon shpesh. Më kot nganjëherë vrapoj që t'a zë.
1. Atëhere kthehem prapa dhe qëndroj ke ndalesa. Shikoj orën me mërzë. Nganjëherë zemërohem me veten time se qysh më ngjan kjo; sidomos në dit të ftohta e me shi s'është e këndshme të qëndrosh më këmbë...por ç'ti bësh.
2. Fut duart në xhep dhe pres autobusin tjetër që vjen pas një gjysmë ore. Shërbimi i autobusave në qytetin tim s'është shumë i mirë.
3. Kur arrin autobusi, pasi të kem pritur një gjysmë ore, hypi në të nga porta e përparme, i paguaj shoferit biletën dhe
4. vete e ulem në fund. Më pëlqen të ulem në fund pasi aty udhëtarët tjerë nuk më shkelin këmbët duke hypur e duke zbritur.
5. Kur arrij në qendër të qytetit zbres nga autobusi, natyrisht nga porta e prapësme, dhe më duhet të bëj gati dy bloqe më këmbë pasi ajo është ndalesa më e afërme e vendit ku punoj.
6. Duke ecur në trotuar kaloj e ndalohem përpara vitrinave të dyqaneve dhe nganjëherë arrij në punë me vonesë.

Fjalor

ndalesë, -a  
më kot  
mërzë, -a  
e përparme  
e prapësme  
e afërme  
trotuar, -i  
vitrinë, -a

stop; pause  
uselessly  
boredom  
front  
rear; hind  
close  
sidewalk  
shop window








Marr një taksì

0. Jam në qendër të qytetit pasi dua të vete në një bankë që nuk e di mirë se ku ndodhet. Në qendër të qytetit ka gjithmonë trafik autobusash, tramvajesh, veturash, kamionash dhe këmbësorësh.
1. Ndodhem në skaj të një trotuari me një grup këmbësorësh duke pritur që të ndërrohet drita e semaforit, kështu që të mund të kalojmë matanë rrugës.
2. Kur ndërrohet drita nga e kuqe në të gjelbër, vihem në lëvizje dhe kaloj matanë rrugës duke ecur brenda vijave të bardha që përbëjnë zonën ku duhet të ecin këmbësorët.
3. Pas pak kohe ndaloj një polic të qytetit dhe e pyes se ku gjendet banka në të cilën dua të vete. Ai më tregon se është në një lagje tjetër të qytetit,
4. por pikërisht as ai vetë nuk e di se në cilin blok të rrugës ndodhet pasi rruga vetë është e gjatë pothuaj dy kilometra. Atëhere thërres një taksì sepse është tepër larg të vete më këmbë.
5. Taksia ndalohet pranë meje. Unë futem brenda e i jap shoferit të taksisë adresën ku duhet të vete. Vetura niset të më shpjerë në vendin e caktuar.
6. Kur arrij pranë bankës shoferi e ndal automobilin; unë e pyes sa i kam, nxjerr paratë nga portofoli, paguaj, hap portën e dal nga taksia.

Fjalor

këmbësor, -i  
për t'u-ndërruar  
semafor, -i  
sa i kam

pedestrian; infantryman  
to be changed  
traffic light  
how much I owe him











## Dal për të bërë një shetitje

0. Pasi është ditë pushimi shkoj të bëj një shetitje. Së pari vete në parkun kryesor të qytetit. Kaloj përmes bankash e lehe lulesh. Shoh një shatërvan e pranë tij bustin e një shkrimtari të famshëm. Matanë, në fund të parkut, dallohen ndërtesat e larta të qytetit.
1. Në një nga sheshet e qytetit ndalohem përpara monumentit të një gjenerali që ka vdekur gjatë luftës për pavarësi.
2. Ndërsa jam duke ecur, një kamion i vogël kalon në rrugë dhe kthehet djathtas. Mbështetur në një shtyllë të elektrikut gjendet një biçikletë.
3. Hypi në një kodrinë prej nga shihet panorama e qytetit. Shoh përpara meje bashkinë, prapa saj kumbonaret e disa kishave, majtas oxhakët e fabrikave e më tutje urën e madhe dhe tej saj kodrat që gjenden në lindje të qytetit.
4. Kthehem përsëri në qytet dhe kaloj nëpër rrugët kryesore.
5. Vete në breg të detit ku shoh mbi ujin e qetë disa barka me vela e një skele të vogël druri mbi të cilën është ulur një peshkatar dhe pranë tij gjenden dy barka.
6. Pasi largohem pak nga bregdeti shoh një kryqëzim hekurudhash. Një tren është duke kaluar mbi një urë hekurudhore dhe është duke hyrë në një tunel, kurse një tren tjetër është duke kaluar nën urë.

Fjalor

për të bërë shetitje	to go for a stroll; to hike
shetitje, -a	stroll, hike, promenade
park, -u	park
bankë, -a	bench
lehe, lehja, lehe, -t	flower bed
shatërvan, -i	fountain (artificial)
bust, -i	bust (statue)
djathtas	to the right, on the right
kodrinë, -a	a small hill
panoramë, -a	panorama
kumbonare, kumbonarja, kumbonare, -t	steeple, church tower
majtas	to the left, on the left
më tutje	farther, further
vel, -i, vela, -t	sail (of a boat); veil
tunel, -i	tunnel








Një shetitje jashtë qytetit

0. Vazhdoj shetitjen dhe dal jashtë qytetit. Si kaloj një urë shoh rreth e përqark meje livadhe, fusha e ara. Më të djathtë shoh dy ferma dhe një bujk duke punuar tokën me traktor. Në anë rrugës gjenden shtyllat e telegrafit. Më të majtë shoh një lopë, matanë gardhit.
1. Nga një bregore shoh diellin duke perënduar në horizont prapa qytetit.
2. Atëhere vendos të kthehem në qytet dhe i kërkoj një motoçiklisti të më marrë me vete.
3. Ai pranon e unë hypi në motoçikletë prapa tij, por shoh se motoçiklisti e nget motoçikletën shumë shpejt, p.sh. ai vete 45 km. n'orë në një zonë ku shpejtësia është e kufizuar në 25 km. në orë.
4. Në një pikë të rrugës një mace do të presë rrugën, por s'e bën dot se mbaron nën rrotat e motoçikletës. Një polic sheh se ç'ngjan dhe na ndjek me motoçikletën e tij.
5. Shoku im ndalohet dhe i thotë policit se ai s'ka faj, por polici i ve një gjobë duke thënë se po të respektonte rregullat e trafikut kjo nuk do të kishte ngjarë.
6. Në një kryqëzim rrugësh ndalemi pasi do të marrim drejtime të ndryshme. Falënderoj motoçiklistin; ai merr rrugën djathtas kurse unë vazhdoj drejt.

Fjalor

rreth e përqark  
fermë, -a  
horizont, -i  
motoçiklist, -i  
motoçikletë, -a  
gjobë, -a

around  
farm  
horizon  
motorcyclist  
motorcycle  
fine (penalty)



Vazhdoj shetitjen e kthehem në shtëpi

0. Gjithë ditën jam jashtë shtëpisë e gruaja është në merak. Shikon nga dritarja e katit të sipërm për të parë në se jam duke ardhur në shtëpi.
1. Arrij në qytet dhe vete të marr metronë. Hyrjet për të vajtur në metro nuk janë shumë afër njera tjetrës, prandaj njeriut i lypset të ecë pak për të gjetur hyrjen që kërkon.
2. Pres të vijë treni që do të marr për të vajtur në shtëpi. Për çudi nuk ka shumë njerëz, por kjo ndofta rrjedh nga shkaku se sot nuk është ditë pune.
3. Pasi arrij në stacionin tim zbres dhe dal nga metroja. Duke i u-ngjitur shkallëve u hedh një sy gazetave dhe revistave të një gazetashitësi.
4. Kaloj nëpër port e shoh një vapor duke u-larguar nga skelja. Në qiell kalon një hidravion që po përgatitet të zbresë në ujë.
5. Pak para se të arrij në shtëpi ndalohe në një vend ku rruga kryqëzohet me hekurudhën e pres që të kalojë treni; kjo më bën të vonohem edhe më shumë.
6. Kur arrij në shtëpi është mbrëmje. Gruaja, e zemëruar, më pret ke porta me duar kryq. Nuk më vajti në mend se ajo do të ishte bërë merak e se isha qellur kaq shumë.

Fjalor

është në merak	he, she is worried
i sipërm	upper
metro, -ja	subway
për çudi	surprisingly
gazetashitës, -i	newspaper vendor
port, -i	port
hidravion, -i	seaplane
për t'u-kryqëzuar	to cross, to be crossed; to be crucified
me duar kryq	with arms folded; idle
për të (më, etc.) vajtur në mend	to occur (to come to the mind)
për t'u-qellur	see "me u-vonue"



## Pjesa C





C-1 Vemi të bëjmë vizitë.

C-2 Në dhomën e pritjes.

C-3 Duke vizituar katin e dytë.

C-4 Në kuzinë.

C-5 Në kopsht e rreth e përqark shtëpisë.











Vemi të bëjmë vizitë

0. Vemi me gruan t'i bëjmë vizitë një familje që njohim. Është e para herë që vemi t'i shohim që kur kanë blerë shtëpinë e re. Pasi nuk banojnë afër nesh, vemi me maqinë.
1. Ndaloj automobilin në buzë të trotuarit përpara shtëpisë dhe zbresim. Zoti Dhori dhe zonja e tij na shohin nga dritarja kur hyjmë në kopsht dhe
2. dalin ne porta të na presin me krahë hapur. Përshëndetemi me ta, u bëjmë urimet për shtëpinë që kanë blerë dhe futemi brenda.
3. Zoti Dhori i merr pallton gruas sime dhe na thotë se tani i lypset të ngrihet në mëngjes më heret pasi kjo shtëpi është mjaft larg nga fabrika ku punon.
4. Pastaj më thotë se, ndonëse është pak larg, lagjja ku banon tani është shumë e pastër, ka mjaft qetësi dhe se ka fqinjë të mirë. Njeri prej tyre është një mik i tij me të cilin ka qenë bashkë në ushtri, shtatë vjet më parë. Më fton të ulem në sofa pranë një llambe me një abazhur të bukur.
5. Ulem bashkë me gruan. Zonja Dhori thotë se kjo shtëpi është më e madhe dhe shumë më e rahatshme se shtëpia në të cilën banonin më parë.
6. Mandej dy nga fëmijët e zotit dhe të zonjës Dhori vijnë të na përshëndesin në dhomën e pritjes. Zoti dhe zonja Dhori kanë tre fëmijë: dy djem dhe një çupë. Skënderi është shtatë vjeç, Vjollca pesë vjeç dhe Petriti gjashtë muajsh.

Fjalor

ne  
abazhur, -i  
çupë, -a

see "ke, te"  
lamp shade  
see "vajzë"









## Në dhomën e pritjes

0. Zonja Dhori ka një dhomë pritje shumë të bukur; e mba pastër e në rregull. Përpara sofasë ka një tavolinë kafeje shumë të bukur dhe një piano të shtrenjtë me një stol përpara.
1. Pas pak kohe që jemi aty, zonja Dhori fton gruan time që të vizitojë shtëpinë. I tregon portretet e babait e të nënës së saj e të zotit Dhori.
2. Pasi gruaja ime ka pak të ftohët, zonja Dhori fut në oxhak një krah dru. Pranë oxhakut ndodhet një mashë për të kapur me të dhe për të rregulluar zjarrin. Mbi oxhak kanë foto-grafitë e dy fëmijëve dhe një vazo me lule të freskëta.
3. Pastaj i tregon bufenë ku gjendet takëmi (servisi) i pjatave dhe qelqurinat. I tregon gruas se disa prej tyre i ka blerë me çmime shumë të arësyeshme nga vëllai i së kunatës dhe shton se po të dëshirojë mund t'i japë adresën e tij. Gruaja pranon me kënaqësi.
4. Mandej hap dritaren e dhomës së bukës pasi dhoma ka qëndruar e mbyllur tërë ditën dhe do që t'i ndërrohet ajri.
5. Këput një kokërr mollë nga molla që është pranë dritares. Përjashta në skaj të shtëpisë, shihet një teneqe me plehrat. Në mur, ngjitur në rubinet, gjendet një zorrë uji.
6. Më në fund zonja Dhori mbyll dritaren dhe së bashku me gruan time, duke u-llafosur, dalin në koridor.

Fjalor

piano, -ja	piano
stol, -i	stool
portret, -i, portrete, -t	portrait
baba, -babai	see "babë"
një krah dru	an armful of firewood
mashë, -a	tongues
vazo, -ja	see "saksi"
bufe, -ja	buffet
takëm, -i	set (of dishes, etc.)
servis, -i	set (of dishes)
qelqurinat, -t	glassware
e arësyeshme	reasonable
për të këputur	to pluck (pick) fruit, flowers; to break (wire, thread, etc.)
teneqe, -ja	tin; container
pleh, -u, plehra, -t	rubbish, garbage; fertilizer
ngjitur	attached to; adjacent
zorrë, -a	intestine: hose
për t'u-llafosur.	see "me folë"






Duke vizituar katin e dytë

0. Lart, në katin e dytë të shtëpisë, gjenden dhomat e fjetjes. Dhoma e zotit dhe e zonjës Dhori është e madhe dhe e mobiluar mirë. Kjo dhomë ka një krevat për dy veta, një komo, një tualet, dy komodina, një raft në mur etj.
1. Zonja Dhori me gruan time u ngjiten shkallëve, duke u-mbështetur në parmak, për të vajtur lart në katin e dytë.
2. Kalojnë përpara banjës e nevojtores dhe zonja Dhori i thotë gruas se shtëpia ka dy nevojtores, një në katin e parë dhe një tjetër në katin e sipërm.
3. Venë në dhomën e fjetjes. Zonja Dhori i tregon gruas disa shishe livandë që ajo mba mbi tualet si dhe disa plaçka tjera.
4. Pastaj shkojnë në dhomën e Petritit, i cili është në djep. Ka një biberon në gojë. Zonja Dhori thotë se Petriti është jashtëzakonisht fëmijë i mirë e qan shumë rrallë.
5. Dalin nga dhoma e zonja Dhori i thotë gruas se tri nga dhomat e fjetjes janë mjaft të mëdha, kurse tjetra, dhoma në të cilën flen Petriti, është më e vogël dhe ka vetëm një dritare. Të tjerat kanë nga dy.
6. E vetmja gjë që nuk i pëlqen shumë zonjës Dhori në shtëpinë e re është se kjo ka dy kate e si rrjedhim i duhet t'u ngjitet e t'u zbresë shkallëve shumë herë gjatë ditës. Duke biseduar në këtë mënyrë që të dyja zbresin në katin e poshtëm.

Fjalor

tualet, -i  
parmak, -u  
livandë, -a  
biberon, -i  
rrjedhim, -i  
i poshtëm

vanity table (a dressing table)  
railing, bannister  
perfume  
nipple, pacifier  
consequence  
lower








Në kuzinë

0. Zonja Dhori është shumë krenare për kuzinën e saj. Ajo ka në të një kuzinë ekonomike, një sqoll modern, rafte etj.
1. Porsa hyjnë në kuzinë, zonja Dhori i tregon gruas sime frigoriferin që gjendet pranë derës. Është një frigorifer i mirë ndonëse nuk është i ri.
2. Në atë çast macja e shtëpisë hyn me vrap në kuzinë duke ndjekur një mi; dy zonjat tremben duke parë një pamje të tillë (nuk dihet pse gratë tremben nga minjtë).
3. Pasi macja zuri miun, zonja Dhori hap raftin e enëve dhe i tregon gruas enët e ndryshme që ajo ka për të gatuar gjellë.
4. Pastaj hap frigoriferin dhe i tregon se ky ka, përveç tre sergjeneve të zakonshëm, edhe tre sergjene në portë nga ana e brendshme.
5. Merr pastaj fshesën nga rafti dhe fshin pjesën e dyshemesë para frigoriferit ku ranë ca fije barishtesh, të cilat i merr me një qyrek e me vurcë dhe i hedh në plehra.
6. Më në fund të dy zonjat pijnë nga një limonadë; pastaj lajnë gotat që kanë përdorur dhe i vënë në vend.

Fjalor

krenar, -e	proud; arrogant
kuzinë ekonomike	stove (for cooking)
sqoll, -i	kitchen sink
sergjen, -i, sergjene, -t	shelf
fshesë, -a	broom
fije, -a, fije, -t	thread; blade (of grass); bit, scrap; matchstick
qyrek, -u	dustpan
limonadë, -a	lemonade





Në kopsht e rreth e përqark shtëpisë

0. Zoti Dhori prapa shtëpisë ka një kopsht të madh me bar, lule e barishte. Aty ka edhe një ahur ku mba disa pula e shpend tjerë dhe një garazh për automobilin e tij.
1. Kur ka pushim, zoti Dhori punon në kopsht; pret e ujit barin, ujit lulet e barishtet, pastron ahurin etj.
2. Pasi dalim në oborr i tregon gruas sime garazhin. Në garazh, përveç automobilin, ai mba edhe plaçka tjera që një ditë mund t'i nevojiten, si p.sh. një gomë automobili, vegla pune etj.
3. Zonja Dhori i tregon gruas se në garazh kanë edhe vendin ku lajnë plaçkat, por nuk e përdorin shumë pasi kanë maqinë larëse.
4. I tregon edhe se maqina larëse ka një vend të veçantë për të shtrydhur plaçkat pasi të lahen, kështu që ajo s'duhet të bëjë gjë tjetër veçse t'i varë pastaj në litar për t'i tharë. Maqina i lehtëson shumë punë zonjës Dhori.
5. Në këtë ndërkohë unë, zoti Dhori dhe fëmijët e tij jemi në oborr prapa shtëpisë, në hijen e një peme, duke ngrënë ca shalqi.
6. Pas pak kohe edhe zonja Dhori me gruan time bashkohen me ne. Rrijmë edhe pak kohë e kur fillon të errësohet u kërkojmë lejë miqvet, i falënderojmë për mirëpritjen, u themi lamtumirë dhe nisemi për në shtëpi.

Fjalor

ahur, -i  
maqinë larëse  
për të shtrydhur  
për të tharë  
për të lehtësuar

shalqi, -ri  
për t'u-errësuar  
mirëpritje, -a

see "ahër"  
washing machine  
to wring; to squeeze  
to dry; to drain  
to facilitate  
(to make easy); to relieve  
watermelon  
to get dark, to darken  
welcome, good reception



Pjesa D








D-1 Në treg: duke blerë harxhin.

D-2 Në kuzinë.

D-3 Duke gatuar.

D-4 Të ftuar për darkë.

D-5 Pasi ikin të ftuarit.










Në treg: duke blerë harxhin

0. Vete në treg për të blerë harxhin. Në treg njeriu gjen të tëra gjërat e ushqimit, që nga barishtet gjer ke pulat e patat. Sheh kanistra të mbushura me pemë e zarzavate; arka plot ve, patate, fasule etj.; thasë me oriz, me sheqer, me kafe etj.; bidona me qumësht; qypa me gjalpë; pula deti, rosa, pata etj. të therura e shumë gjëra tjera. Pothuaj mbi çdo banak sheh një balancë (terezi) për të peshuar ushqimet që blejnë myshteritë.
1. Pasi blej gjërat e ushqimit që më nevojiten kthehem në shtëpi me dy qese prej karte, plot. Gruaja më hap portën pasi unë i kam të dyja duart të zëna dhe
2. pasi hyj brenda vete drejtpërdrejt në kuzinë, ve harxhin mbi trapezë dhe vete të marr postën nga kutia që kemi pranë portës së shtëpisë.
3. Gruaja nxjerr gjërat e ushqimit nga qeset prej karte dhe i ve mbi tryezë. Nxjerr një shishe vaj bimësh, ca qumësht, ajkë, një kuti kafe etj. dhe
4. pastaj fut në raft një pjesë të tyre, dhe ato ushqime që mund të prishen i fut në frigorifer.
5. Duke bërë këtë punë i shket nga dora një shishe uthull dhe i bie në dysHEME e thyhet.
6. Merr pastaj copat e shishes së thyer dhe i hedh në teneqenë e plehrave që mbajmë në një qoshe.

Fjalor

kanistër, kanistra, kanistra, -t	large basket; hamper
fasule, -fasulja, fasule, -t	see "groshë"
bidon, -i	can
të therura	butchered, slaughtered
banak, -u	counter
balancë, -a	scales
terezi, -a	scales
myshteri, -u, myshteri, -të	customer
qese, qesja	bag
të zëna	occupied (busy)
trapezë, -a	see "tryezë"
vaj bimësh	vegetable oil
ajkë, -a	cream
për të shkarë	see "me rrëshqitë"
e thyer	broken; defeated









Në kuzinë

0. Ndërsa gruaja e ulur në një karrigë pranë një tryeze në kuzinë qëron disa patate dhe i fut në kusi, unë, duke ndenjtur më këmbë, grij mishin në maqinë me të cilin gruaja do të gatujë ca qofte për darkë.
1. Pastaj, kur mbaron së qëruari patatet, merr kuzinë me to, e ve në sqoll dhe hap musllukun e ujit të ftohët për t'i larë.
2. Më vonë unë pres një kokë lakër për t'a bërë turshi dhe kur mbaroj, laj thikën dhe e fut në sirtarin e tryezës.
3. Gruaja në këtë ndërkohë përgatit një sahan me çorbë. Pasi i fut kripë e piper e ve në zjarr për t'a zier kështu që të jetë gati në kohë të darkës.
4. Kur janë zier patatet, gruaja i merr i shtyp dhe i bën pure e më thotë mua t'i përziej, ndërsa ajo i fut pak qumësht e gjalpë.
5. Gruaja merr ca miell, e njom me qumësht dhe e ngjesh për të bërë me brumin një ëmbëlsirë.
6. Ajo nxjerr nga frigoriferi ca mish që kam blerë ditën më parë. Pasi e shikon më thotë se ai mish do të ketë ndenjtur në vitrinën e kasapit kush e di sa dit, pasi ka filluar të priset. Unë i them se s'është ashtu pasi kasapi e preu para syve të mi nga kofsha e një dashi kur e bleva.

Fjalor

për të qëruar  
kusi, -a  
për të grirë  
të qëruar, -it  
turshi, -a  
sahan, -i  
piper, -i  
për të zier  
për t'u-zier  
për të përzierë  
për të njomur  
për të ngjeshur  
brumë, -i  
kasap, -i

to peel; to clean, cleanse; to clear  
pot, pan, kettle  
to grind up (meat); to dice  
peeling  
pickle  
large bowl  
pepper  
to boil  
to be boiled  
to stir; to mix  
to moisten  
to knead  
dough  
butcher












## Duke gatuar

0. Shumë burrave u pëlqen të gatujnë; disa tjerë e kanë për zanat (pasi tërë gjellëbërësit janë burra) dhe ka prej atyre që as s'u pëlqen as nuk e kanë për zanat. Unë jam një prej këtyre, por nganjëherë më duhet të gatuj, pasi gruaja ka tjetër orar pune e vjen në shtëpi nga puna në orën 19:30. Kështu, dashur ose pa dashur, më lypset të gatuj.
1. Nganjëherë fut në furrë të kuzinës ekonomike një pulë me patate dhe e pjek.
2. Ndonjëherë tjetër ndez furnellin me gaz (pasi është e tepër të ndez kuzinën ekonomike me dru) dhe fërgoj në tigan peshk, mish, ve etj.
3. Nganjëherë gatuj makarona. Së pari bëj salcën; pastaj marr një kusi të madhe dhe e mbush me ujë dhe e ve në zjarr. Kur valon uji thyej makaronat (kur janë të gjata) dhe i hedh brenda.
4. Ndonjëherë, por shumë rrallë, kur më teket, pjek edhe bukë.
5. Mua dhe gruas na pëlqen shumë supa, prandaj pothuaj çdo tri a katër dit bëj supë: supë me barishte, supë me oriz, supë me ve ose vetëm lëng mishi.
6. Mbas darke e kemi zakon, si unë ashtu gruaja, të pijmë ja kafe ja çaj, prandaj porsa mbarojmë së ngrëni gruaja heq nga zjarri ibrikun me ujë të valuar dhe përgatit kafënë ose çajin.







Fjalor

dashur ose pa dashur  
 furrë, -a  
 për të pjekur  
 furnell, -i  
 tigan, -i  
 për të fërguar  
 e tepër  
 për të valuar  
 të ngrënë, -t  
 ibrik, -u  
 i valuar

willy-nilly (without choice)  
 oven; bakery  
 to bake; to meet  
 hot plate  
 frying pan  
 to fry  
 superfluous; extra, one too many  
 to boil  
 eating  
 teakettle  
 boiled







Pasi ikin të ftuarit

0. Gjëja më e mërzitshme, pasi ikin të ftuarit, është të larët e enëve. Sidomos kur dua të vete me gruan gjëkundë pas darke, këtë punë nganjëherë e bëj unë. Për të mbaruar punë sa më shpejt unë laj pjatat dhe gruaja pastron e ve në rregull dhomën e bukës, dhomën e pritjes dhe kuzinën.
1. Ve përparjen dhe vete në dhomën e bukës dhe ngre nga tryeza qelqurinat, pjatat, lugët, thikët, pirunët etj.
2. Ve pjatat njerën mbi tjetrën në një tabaka dhe i shpie në kuzinë. Pastaj kthehem në dhomën e bukës dhe marr nga trapeza çdo gjë që është për t'u-larë dhe këtë e bëj gjer sa i kam ngritur të tëra.
3. I ul pastaj një nga një e i fut në sqoll, hap musllukun e ujit të ngrohët dhe rregulloj ujin që mos të jetë shumë i nxehtë, i shtie ca sapun pluhur dhe
4. filloj t'i laj duke përdorur një shpuzë. Si të mbaroj së lari çdo pjatë dhe çdo gotë i ve njerën pranë tjetrës në një vend të veçantë pranë sqollit që të kullojë uji. Kjo punë zakonisht nuk më merr shumë kohë.
5. Pastaj, kur gruaja mbaron së rregulluari dhomat, vjen dhe i than enët me një leckë të pastër.
6. Më në fund unë i ngre nga sqolli dhe i sjell pranë dollapit dhe ajo i ve një nga një në vendin e tyre.

Fjalor

e mërzitshme  
përparje, -a  
pluhur, -i  
për të kulluar  
të rregulluar, -it  
leckë, -a  
dollap, -i

boring  
apron  
powder; dust  
to drip; to filter; to strain  
putting in order  
rag  
see "raft"



Pjesa E






E-1 Përgatitem për një udhëtim.

E-2 Në stacion të trenit.

E-3 Hypi në tren.

E-4 Në udhëtim e sipër.

E-5 Në udhëtim e sipër (vazhdim).








Pregatitem për një udhëtim

0. Stacioni i trenit në qytetin tim gjendet pothuaj në qendër të qytetit. Udhëtarët mund të shkojnë aty me mjete të ndryshme: me tramvaj, me autobus, me taksi ose edhe më këmbë në qoftë se nuk banojnë larg prej aty. Stacioni është në një godinë të hieshme në majë të së cilës gjendet një sahat.
1. Vete në bodrum të marr baullen dhe e sjell në dhomën e gjumit. E hap e fut në të kostumet, këpucët etj. dhe pastaj e mbyll. Pasi të kem bërë gati baullen, marr valixhen dhe e ve mbi një stol. E hap dhe
2. fut në të këmishët, brekët, fanellat, çorapet dhe në një skaj ve kutinë e tualetit me veglat e rrojës, me pastën e dhëmbëve, krëhrin etj.
3. Pasi mbyll edhe valixhen, e marr së bashku me baullen dhe i fut në kamionin e vogël që kam përpara shtëpisë.
4. Gruaja del të më thotë lamtumirë. Unë e përqafoj dhe e puth e ajo fillon të qajë. Shumë gra e kanë zakon të qajnë në të tilla raste.
5. Unë hypi në maqinë dhe nisem për në stacionin e trenit. Kur arrij para portës së magazinës së stacionit ndalohe dhe
6. shkarkoj plaçkat nga kamioni dhe i shpie në magazinë (me përjashtim të një valixhje që do t'a mbaj me vete) ku një nëpunës i stacionit i peshon dhe më jep një dëftesë.

Fjalor

baulle, baullja  
dhomë gjumi  
për të bërë gati  
veglat e rrojës  
për të përqaftuar

trunk  
see "dhomë fjetje"  
to prepare; to pack  
shaving kit  
to embrace






## Në stacion të trenit

0. Një nga vendet me lëvizje të vazhdueshme njerëzish është stacioni i hekurudhës. Aty njeriu sheh në çdo orë të ditës ose të natës njerëz duke u-nisur ose duke arritur; njerëz që presin, njerëz që marrin ose depozitojnë valixhet, udhëtarë duke blerë bileta etj.
1. Si arrij në stacion, zbres shkallët kryesore dhe hyj në sallë, kaloj përpara zyrës së informatave dhe
2. vete të shoh orarin e trenave në arritje e në nisje. Gjej trenin që vete në qytetin ku dua të shkoj dhe shoh se treni nisët pas dyzet minutash.
3. Vete në sportel dhe i them nëpunësit të më japë një biletë vajtje e ardhje dhe e pyes se sa kushton.
4. Nëpunësi më pret dy bileta dhe më tregon çmimin. Unë nxjerr nga xhepi paratë dhe paguaj. Marr biletën, e fut në xhep dhe
5. vete të pres kusurin e kohës në sallën e pritjes. Qëndroj ulur në një bankë gjersa megafoni lajmëron se është hapur porta për të vajtur në trenin që do të marr unë.
6. Ngrihem dhe vihem në radhë me pasagjerët tjerë dhe dal nga porta e sallës ku një nëpunës i hekurudhës më kontrollon biletën.

Fjalor

për të depozituar  
 arritje, -a  
 për t'u-vënë në radhë

to deposit  
 arrival  
 to fall in line







Hypi në tren

0. Si dal nga salla e pritjes vete në platformën e stacionit ku ndalen e prej nga nisen trenat. Platforma është krejt e mbuluar dhe çdo palë binarë kanë një numër për t'u lehtësuar udhëtarëve mëyrën që të gjejnë trenin që duhet të marrin. Edhe në platformë, sikurse në sallën e pritjes, ka gjithëmonë lëvizje: udhëtarë që vijnë, udhëtarë që shkojnë, pasagjerë që kërkojnë trenin që do të marrin, njerëz duke telefonuar në kabinat e shumta të telefonit, hamaj me valixhe etj.
1. Thërres një hamall dhe i them të më çojë valixhet në tren. Më pyet sa valixhe kam pasi do që të marrë një karrocë dore për t'i transportuar. I them se kam vetëm një valixhe me vete. Ai e merr në sup dhe drejtohet për në vendin ku është treni.
2. Kur arrijmë ke vagoni, në të cilin gjendet vendi im, hypi në të dhe i them hamallit të vijë pas meje.
3. Hap portën me xhame të kompartimentit tim dhe hyj brenda dhe pas meje hyn edhe hamalli,
4. i cili ve valixhen në vendin e vet. I paguaj hakun dhe i jap një bakshish. Ai më falënderon dhe ikën.
5. Hap dritaren e ulem në kolltuk. Tani jam gati dhe s'kam asgjë për të bërë veçse të pres nisjen e trenit.
6. Pas pak kohe dëgjoj përjashta zërin e një gazetashitësi; dal në dritare e blej një gazetë prej tij dhe pasi ulem filloj të këndoju.

Fjalor

platformë, -a  
për të telefonuar  
kompartiment, -i  
hak, -u  
bakshish, -i

platform  
to phone  
compartment  
charge (for a service); wage  
tip






Në udhëtim e sipër

0. Kur vjen ora e nisjes treni është gati të vihet në lëvizje. Lokomotiva është furnizuar me qymyr guri e me ujë dhe maqinisti pret vetëm shenjën e nisjes nga nëpunësi përkatës i stacionit. Të gjithë udhëtarët kanë zënë vend dhe portat e vagonave janë mbyllur.
1. Në orën e caktuar nëpunësi përkatës i stacionit vjen në platformë dhe me anë të një bilbili dhe të një llambe me ngjyra (i drejton maqinistit dritën e gjelbër) jep shenjën e nisjes.
2. Pasi largohet pak treni nga stacioni, kontrollorët venë nëpër kompartimente për të shikuar në se të gjithë udhëtarët kanë blerë biletat. Kontrollori vjen edhe në kompartimentin tim.
3. Shikoj biletën që bleva në stacion për të parë në se kam paguar edhe për të drejtën që të flej në krevat një natë. Kontrollori, i cili është edhe biletashitës, më thotë se jo e atëhere blej prej tij një biletë (për të fjetur në krevat).
4. Një shitës ambulant hyn në kompartimentin tim dhe më pyet në se dëshiroj të blej ndonjë gjë për të ngrënë. Blej prej tij një bukë me suxhuk.
5. Më venë sytë në dorëzën e alarmit; atëhere ngrihem nga kolltuku dhe këndoj lajmërimin nën të se kur e se si duhet përdorur.
6. Pastaj dal nga kompartimenti dhe vete në nevojtoare.

Fjalor

lokomotivë, -a	locomotive
për t'u-furnizuar	to be furnished, supplied, equipped
qymyr guri	coal
maqinist, -i	machinist; train engineer
nëpunësi përkatës	the employee in charge
bilbil, -i	whistle; nightingale
kontrollor, -i	train conductor; controller, comptroller
shitës ambulant	peddler
suxhuk, -u	sausage
lajmërim, -i	notification; warning





Në udhëtim e sipër (vazhdim)

0. Gjatë një udhëtimi me tren pasagjerët e kalojnë kohën si të munden. Disa kuvendojnë, disa tjerë venë poshtë e lart nëpër tren dhe shumica e kalojnë kohën duke kënduar. Kur arrin treni në ndonjë stacion ka udhëtarë që zbresin e të tjerë që hypin në tren, ka edhe prej atyre që nxjerrin kokën nga dritarja për të shikuar rreth e përçark e për të parë se ku ndodhen.
1. Kur vjen koha e darkës dal nga kompartimenti im dhe drejtohem për në vagonin-restorant të trenit.
2. Hap derën e vagonit dhe hyj brenda. Shoh se ka mjaft tryeza të lira. Ulem në një tryezë.
3. Marr dhe shikoj listën e gjellëve. Vjen kamerieri, të cilit i them se ç'dua të ha. Ai mba shënim gjellët që porosit dhe largohet.
4. Pasi më sjell kamerieri gjellën, një udhëtar më kërkon lejë dhe ulet në tavolinën ku jam ulur unë dhe fillojmë të llafosemi përmbi udhëtimin etj.
5. Kur mbaroj së ngrëni, paguaj kamerierin, ndahem nga shoku i tryezës dhe vete në kompartimentin ku janë krevatet. Gjej krevatin tim, xhvishem dhe bie të flej.
6. Të nesërmen në mëngjes pasi zgjohem treni arrin në stacion. Vishem me të shpejtë dhe dal nga vagoni. I jap një hamalli valixhen dhe drejtohem për në portën e stacionit.

Fjalor

ndahem nga shoku i tryezës

I leave my supper companion



Pjesa F







F-1 Një udhëtim përjashta shtetit.

F-2 Në aeroport.

F-3 Një udhëtim me aeroplan.

F-4 Në vapor.

F-5 Arritja.









Një udhëtim përjashta shtetit

0. Drejtori i shoqërisë ku punoj më thërret në zyrën e tij e më lajmëron se shoqëria do të më dërgojë me detyrë për dy muaj në Angli. Pastaj drejtori më thotë se duhet të vete për ca kohë edhe në Francë prej nga do të kthehem në ShBA. Shoqëria jonë ka shumë degë nëpër vendet e ndryshme të botës. Në një glob drejtori më tregon se ku do të vete e ç'duhet të bëj.
1. Vete në një agjenci turistike ku blej biletat e nevojshme për udhëtimin që do të bëj dhe i kërkoj nëpunësit disa informata mbi udhëtimin, orarët etj.
2. Pastaj vete në ambasadën angleze e në ambasadën franceze për të marrë vizën.
3. Nëpunësit e ambasadave më vistonë pasaportën, kështu që tani jam gati për udhëtim.
4. Jam i gëzuar të largohem për disa kohë nga puna e zakonshme e përditshme, nga shkresat, nga telefoni etj.
5. Pasi marr valixhen me plaçka dal nga shtëpia dhe mbyll derën me kyç. Marr një taksì për të vajtur në aeroport.
6. Rrugës mendoj që kur të vete në Francë, pasi të mbaroj punë, të kërkoj dy javë lejë e të shkoj e t'i kaloj në një nga plazhat e shumta të Mesdheut. Kam qejf të shkoj për tri a katër dit në Monte Karlo për të provuar fatin.

Fjalor

glob, -i  
vizë, -a  
për të vistuar  
kyç, -i  
Mesdhe, -u

globe  
visa; line  
to endorse a passport with a visa  
see "çelës"  
The Mediterranean Sea










Në aeroport

0. Si arrij në aeroport zbres nga taksia dhe drejtohem për në godinën qendrore të aeroportit ku janë zyrat, salla e pritjes, bufeja etj. Ndërsa vete aty shoh hangarët e aeroportit, aeroplanat që përgatiten për nisje, pasagjerë duke hypur ndër aeroplana dhe një aeroplan që është duke zbritur në aerodrom.
1. Aeroplani me të cilin do të nisem unë, një katërmotorsh, po bëhet gati. Disa mekanikë janë duke kontrolluar pjesët e ndryshme: një mekanik kontrollon helikat, një tjetër gomat e rrotave e kështu me radhë.
2. Dy mekanikë tjerë po i fusin benzinë nga një autoçisternë dhe kur mbarojnë punë largojnë automjetin nga pista.
3. Kur vjen ora e nisjes aeroplani është gati. Një nëpunës i linjës ajrore na hap portën e hyrjes në aeroport dhe pasagjerët venë për ke aeroplani.
4. Në këtë ndërkohë disa punëtorë të aeroportit ngarkojnë valixhet dhe thasët e postës në aeroplan.
5. Zakonisht, ja ke këmbët e shkallëve ja ke porta e aeroplanit një nëpunës kontrollon biletat. Kësaj radhe na i kontrolluan ke porta. Hypi në aeroplan duke u-mbajtur në parrakët e shkallëve.
6. Gjej kolltukun tim, numri i të cilit është shënuar në biletë; ulem në të dhe mbërthej rreth vetes rrypin e sigurimit.

Fjalor

mekanik, -u, mekanikë, -t  
e kështu me radhë  
autoçisternë, -a  
linjë ajrore  
kësaj radhe  
rrypi i sigurimit

mechanic  
and so on  
gasoline truck  
air line  
this time  
safety belt












Një udhëtim me aeroplan

0. Kur ngrihen e kur ulen aeroplanat pothuaj përherë kalojnë përmbi një pjesë të madhe të qytetit e kjo ndodh kur aeroportet nuk janë shumë larg nga qyteti vetë. Edhe aeroplani në të cilin jam unë, pasi ngrihet nga fusha, kalon mbi një pjesë të madhe të qytetit,
1. bën një gjysmë kthese nga e majta dhe pastaj vete drejt nga lindja.
2. Në këtë ndërkohë, në kabinën e komandimit piloti duke kontrolluar sahatat shpie aeroplanin përmbi shtresën e reve, ndërsa radisti njofton me radio aeroportin se çdo gjë është në rregull.
3. Brenda në aeroplan të gjithë udhëtarët janë të ulur ndër kolltukë dhe nëpunësja vete nga një pasagjer tek tjetri duke pyetur në se kemi nevojë për ndonjë gjë dhe, atyre që dëshirojnë, u sjell ndonjë pije freskuese.
4. Kolltuku im është pranë dritares e herë pas here shikoj poshtë në tokë. Nëpunësja na lajmëron të mbërthejmë rrypat e sigurimit pasi në pak minuta do të zbresim në aeroport.
5. Dalngadalë aeroplani fillon të zbresë. Dëgjoj rrotat që takojnë në tokë dhe pastaj aeroplani ndalet përpara godinës kryesore të aeroportit. Çelet porta e aeroplanit e të gjithë udhëtarët, një nga një, zbresin në tokë.
6. Si marr valixhet nga depoja thërrës një taksi e i them shoferit të më shpjerë në port. Nuk kam shumë kohë pasi vapori me të cilin do të vete në Europë niset po atë pasdreke.

Fjalor

komandim, -i  
sahat, -i, sahata, -t  
radist, -i  
të ulur  
pije freskuese  
dalngadalë  
për t'u-çelur

command; commanding  
dial  
radio operator  
seated  
soft drink  
slowly; gradually  
to be opened








Në vapor

0. Arrij në port e mundohem të gjej skelen në të cilën është ankoruar vaporin që do të marr. Shoferi i taksisë nuk e di mirë portin, prandaj ndalem e vete në një zyrë ku më drejtojnë për në skelen përkatëse. Zona e portit është e gjerë e nuk është gjë e lehtë të gjesh menjëherë vaporin që kërkon.
1. Kur arrij ke vaporin zbres nga taksia, marr valixhet e vihem në radhë me pasagjerët tjerë dhe hypi në vapor. Është një vapor i madh pasagjerësh dhe shpresoj të bëj një udhëtim të mirë me të.
2. Në skelen kundrejt skeles sonë shoh një vapor tregëtar duke ngarkuar mall me vinçin e tij.
3. Hypi në vapor dhe vete të gjej kabinën time. Si e gjej, hap portën dhe hyj brenda. Kabina s'është e madhe, por nga ana tjetër kabinat e vaporit nuk janë kurrë të mëdha.
4. Lë plaçkat në kabinë e dal në kuvertë pasi u-afrua ora e nisjes. Mbi kuvertë shoh spirancën e vaporit, i cili fillon të largohet nga skelja.
5. Porsa dalim jashtë portit fillon të fryjë erë dhe dallgët zënë të lëkundin vaporin e
6. unë filloj të dëgjoj trazim në stomak; fillon të më zëjë deti.

Fjalor

për t'u-ankoruar  
përkatëse  
vinç, -i  
kuvertë, -a  
spirancë, -a  
për të lëkundur

to be anchored  
appropriate; proper; pertinent  
winch  
deck  
anchor  
to rock, sway, shake



Arritja

0. Kur vete nga një shtet në një tjetër, udhëtari duhet të kalojë nëpër shumë veprime burokratike, por si thonë nëpunësit, rregullat janë rregulla e duhen respektuar. Një nga kokëçarjet është të kaluarit nëpër doganë.
1. Vaporit, në të cilin ndodhem, arrin në zonën e portit e ndalet për të pritur rimorkiatorin; ky vjen dhe tërheq vaporin në skelen e caktuar.
2. Zyra e vaporit lajmëron që udhëtarët mund të fillojnë të zbresin në tokë. Kur më vjen radha zbres edhe unë. Në fund të shkallëve i tregoj pasaportën rojës së kufirit dhe vete në zyrën e doganës.
3. Nëpunësi i doganës më pyet sa para kam në valutë të huaj dhe në qoftë se dua t'i shkëmbej këto para në valutën e vendit. Pasi ndërroj paratë
4. vete ku janë valixhet dhe doganieri më thotë se kam disa cigare e një shishe liker, për të cilat duhet ja të paguaj taksën doganore ja t'i lë aty gjer sa të largohem nga shteti e t'i marr me vete.
5. Pasi vendos të paguaj taksën i marr e i fut në valixhe e vete
6. në ambulancën e doganës ku i tregoj mjekut raportin që kam marrë para se të nisem, me të cilin provohet se kam bërë gjilpërat e imunitetit kundër sëmundjeve ngjitëse.

Fjalor

burokratik, -e	bureaucratic
kokëçarje, -a, kokëçarje, -t	bother; headache (fig.)
të kaluar, -it	passing, going through
rimorkiator, -i	tugboat
për të shkëmbyer	to exchange
doganier, -i	customs agent
gjilpërë, -a	needle; injection
imunitet, -i	immunization; immunity



## Pjesa G








G-1 Një vizitë mjekësore në spital.

G-2 Vizitë mjekësore dhe mjekim.

G-3 Vazhdim i vizitës mjekësore.

G-4 Bëhem operacion.

G-5 Ke dentisti.










Një vizitë mjekësore në spital

0. Ka disa dit që nuk e ndiej veten mirë, prandaj vendos të vete në spital për të bërë një vizitë mjekësore të përgjithshme. Si hyj në spital vete në banak ke sekretarja, e cila, pasi merr informatat e duhura si p.sh. emrin e mbiemrin, datë lindjen, sëmundjet që kam kaluar etj., më cakton një krevat në një nga pavionet e spitalit.
1. Pas pak kohe që jam shtruar vjen mjeku dhe më pyet se si jam. I tregoj se kam dhëmbje koke të fortë. U hedh një sy shënimeve që ai ka me vete e
2. më thotë të ngrihem më këmbë. Më kontrollon mushkëritë e gjoksin me stetoskop. Më thotë të marr frymë thellë me hundë e t'a nxjerr nga goja.
3. Pastaj më thotë të ulem në një stol e më kontrollon përsëri mushkëritë nga ana e shpinës e më thotë se mushkëritë janë në rregull.
4. Më mat presionin e gjakut e më thotë se e kam pak të lartë. Më këshillon të mbaj pehriz për ca kohë e më thotë se do të më japë një listë me gjërat që duhet të ha e me gjërat që s'duhet të ha.
5. Më thotë të ngrihem nga stoli e të vete e të ulem në një karrigë me shpinzë, të qëndroj drejt e të ve këmbën mbi këmbë. Me një çekiç prej llastiku më kontrollon reflekset duke më qëlluar lehtë nën kupën e gjurit.
6. Mandej më thotë të ngrihem më këmbë dhe me një vegël të veçantë më kontrollon veshët.

Fjalor

pavion, -i  
dhëmbje, -a  
stetoskop, -i  
në rregull  
për të mbajtur pehriz  
shpinzë, -a  
çekiç, -i  
llastik, -u  
refleks, -i, reflekse, -t  
lehtë  
kupa e gjurit

ward (hospital); pavilion  
see "dhimbë"  
stethoscope  
in order  
to diet, to go on a diet  
the back of a chair, etc.  
hammer  
rubber; rubber band, etc.  
reflexes  
gently  
kneecap









Vizitë mjekësore dhe mjekim

0. Mjeku më thotë të vete në laborator për të bërë ca radiografi e një radioskopi të përgjithshme. Posa hyj një nga mjekët më thotë të xhvishem e më ve përpara aparatit Roentgen. Pasi më bën 7-8 radiografi më shikon në radioskopi e kur mbaron më thotë të vishem e të vete në një seksion tjetër të spitalit për të vazhduar vizitën mjekësore. Më thotë se do të shqyrtojë radiografitë e pas dy ditësh do të marr përgjegjen.
1. Pasi dal nga laborator vete ke okulistin, i cili më viziton sytë dhe më thotë se çdo gjë është në rregull.
2. Pastaj vete në seksionin e sëmundjeve të hundës e të grykës. Specialisti më kontrollon së pari grykën e bajamet
3. dhe pastaj hundën. Më thotë se s'kam gjëkafshë e më dërgon në repartin e sëmundjeve të brendshme.
4. Një doktor më ndien pulsën dhe më thotë se e kam pak të shpejtë prandaj
5. më jep disa hape e më thotë t'i gëlltit aty-për-aty; gjithashtu më thotë se do të më japë një recetë për të blerë ca ilaçe në një farmaci pasi të dal nga spitali e të kem mbaruar të gjitha vizitat mjekësore.
6. Pastaj merr një copë pambuk të lagur në alkool, më pastron një vend në krah dhe më bën një gjilpërë.

Fjalor

radiografi, -a  
okulist, -i  
bajame, -t  
gjëkafshë  
puls, -i  
farmaci, -a  
i lagur  
alkool, -i

X ray  
ophthalmologist, eye doctor  
tonsils  
anything; nothing  
pulse  
pharmacy  
wet  
alcohol









## Vazhdim i vizitës mjekësore

0. Mjeku më shtrin e fillon të më kontrollojë duke shtypur me gishtërinj stomakun e barkun. Kur më prek në zonën e zorrës qorre kam një dhëmbje të fortë e të mprehtë. Doktorin e përsërit këtë gjë dhe dy a tri herë tjera dhe gjithnjë përsëritet edhe dhëmbja. Pas kësaj më thotë të ngrihem në këmbë.
1. të ve duart në ijë e të përkulem sa majtas djathtas dhe më pyet në se ndiej dhëmbje në anën e djathtë. I them se po.
  2. Atëhere më thotë të marr frymë thellë e t'a mbaj frymën gjer-sa të më thotë ai e në këtë ndërkohë, më prek me gishtërinj në vendin e zorrës së verbër. Më thotë se është mirë të bëhem operacion se kam apendicit.
  3. Më shikon në shpinë e më thotë se kam një lungë të vogël, të cilën m'a lyen me një melhem e më thotë se do të shërohet vetvetiu.
  4. Pastaj më kontrollon këmbët. Më thotë se kam damarët e këmbës të ënjtur dhe
  5. kam gjithashtu të ënjtur edhe nyellin e këmbës. Atëhere unë i tregoj se tri dit më parë e zura keq duke zbritur shkallët e godinës ku punoj dhe se po atë natë kish filluar të ënjet.
  6. Më tregon se kam tabanin e njerës këmbë dyst e më këshillon të ve brenda në këpucë një shuall të ngritur të bërë veçanërisht për njerëz që janë dyst taban.

Fjalor

për të shtrirë	to stretch; to spread out;
më shtrin	to knock down; to fell
gishtërinj, -të	he makes me lie down
zorra qorre	fingers, toes
i mprehtë	appendix (Anat.)
për t'u-përsëritur	see "i prefët"
ijë, -a	to come back, recur
zorra e verbër	hip
apendicit, -i	appendix
lungë, -a	appendicitis
melhem, -i	abscess, cyst
për t'u-shëruar	ointment
damar, -i, damarë, -t	to be cured
i ënjtur	vein, artery
nyell, -i	swollen
për t'u-ënjtur	ankle
	to swell

(continued on p. 81)







## Bëhem operacion

0. Në mëngjes vjen një infermier pranë krevatit dhe më lajmëron se erdhi koha të bëhem operacion dhe se kirurgu është gati. Më ve në një lloj krevati me rrota dhe më shpie në sallën e operacionit.
1. Në koridor përpara portës së sallës shoh një infermiere që hyn përpara meje me një tryezë të vogël më rrota mbi të cilën gjenden veglat e operacionit, disa ilaçe etj.
2. Si hyj në sallë një doktor më shtrin në tryezën e operacionit dhe më ve maskën e anesteziës e pastaj kirurgu më bën operacion.
3. Mbasdreke, kur kam ardhur në vete, doktori vjen dhe pasi më pyet si jam më ngre nga krevati dhe më ndërron lidhet. Më thotë që herë pas here të ngrihem e mos të qëndroj në krevat pa lëvizur tërë ditën.
4. Në mbrëmje kam pak ethe, por fle tërë natën. Kur vjen mjeku të më vizitojë në mëngjes konstaton se kam patur ethe. Atëhere
5. thërret një infermiere, e cila vete dhe sjell një shishe me gjak dhe më bën një transfuzion duke shtënë tubin e hollë të shishes në damarin e krahut.
6. Pas pesë ditësh mjeku më heq kapësat dhe më lajmëron se jam shëruar e mund të dal nga spitali, por duhet të vij pas një jave edhe një herë që të më kontrollojë plagën. Të nesërmen në mëngjes bëj gati plaçkat dhe kthehem në shtëpi.

Fjalor

kirurg, -u	surgeon
maskë, -a	mask
anestezi, -a	anesthesia
për të ardhur në vete	to regain consciousness, to come to
lidhe, lidhja, lidhe, -t	bandage
për të konstatuar	to find out; to ascertain; to perceive
transfuzion, -i	transfusion
tub, -i	tube; pipe
kapës, -i, kapësa, -t	clamp, clip, clasp
<hr/>	
(Continued from G-3)	
taban, -i	sole (of foot)
dyst	flat; smooth
shuall, -i, shuaj, -t (shoje, -t)	sole (leather)
i ngritur	elevated
dyst taban	flat-footed





Ke dentisti

0. Pasi më dhëmb një dhëmballë vete ke dentisti. Posa hyj i tregoj dentistit se cila dhëmballë më dhëmb. Ai më thotë të ulem. Më jep ca ujë të vakët me pak dezinfektant për të shplarë gojën e në këtë ndërkohë ai përgatit veglat.
1. Më kontrollon dhëmbët e më thotë se i kam në gjendje mjaft të mirë, por disa prej tyre kanë nevojë të mbushen.
2. Dy janë në gjendje kaq të keqe sa duhen hequr, prandaj më bën një gjilpërë me anestezi lokale dhe me një darë i shkull që të dy njerin pas tjetrit.
3. Më jep pastaj një qelq me një ilaç për të shplarë gojën e për të ndaluar gjakun.
4. Pas tri ditësh vete përsëri ke dentisti për të mbushur dhëmbët. Së pari ai gërryen vrimat me anë të një turjele dhe
5. pastaj i mbush e i lëmon me kujdes. Kur mbaron të mbushurit e dhëmbëve
6. më merr masën për një urë prej tri dhëmballësh që do të ve në nofullën e poshtme, në anën e djathtë. Pasi mbaron punë më thotë të vete përsëri ke ai pas një jave që të shohë në se ura do të më bjerë mirë. Më thotë që të mos ha gjë për dy orë pasi mund të prishet lënda me të cilën ka mbushur dhëmbët.

Fjalor

darë, -a  
për të gërryer  
për të lëmuar  
të mbushur, -it  
nofull, -a

pliers, forceps  
to scrape; to hollow; to erode  
to smooth  
filling  
jaw



Pjesa H





H-1 Ke mishtari e ke bukëpjekësi.

H-2 Duke blerë gjëra ushqimi.

H-3 Në një dyqan veshmbathje dhe në këpucëtore.

H-4 Nëpër dyqane të ndryshme.

H-5 Nëpër dyqane të ndryshme (vazhdim).








## Ke mishtari e ke bukëpjekësi

0. Kur shkoj ke mishtari qëndroj zakonisht për pak kohë përpara vitrinës për të vendosur se çfarë do të blej. Kur gruaja më pregatit listën atëherë s'është problem, por përndryshe është kokëçarje e madhe që të vendos çfarë mishi të marr. Në vitrinën brenda në dyqan ashtu edhe varur në çengele mishtari mba lloje-lloje mishrash, suxhukësh, shpendësh të therur etj.
1. Nganjëherë kur shoh mishin varur ke mishtari, më vete mendja se si kasapët therin bagëtinë.
2. Pasi shikoj të gjitha mishrat vendos të blej një gjysmë kofshe dashi dhe
3. pastaj blej dhe ca mish derri. Pyes për çmimin e bërzoollave të dërrit, të proshutës, të salameve, të suxhukëve etj. dhe vendos të marr dhe ca proshutë.
4. Dal nga mishtari e vete ke bukëpjekësi. Kur hyj në dyqan vendos të blej, përveç bukës, edhe një ëmbëlsirë. Më venë sytë në pjesën e prapme të dyqanit ku gjendet furra dhe shoh dy furrxhi duke punuar: njerin duke ngjeshur bukë dhe tjetrin duke i futur në furrë.
5. I them shitëses të më japë dy franxholla dhe e pyes për çmimin e disa pastave që duken se janë të freskëta, por
6. ndërroj mendim dhe blej një revani me kremë.

Fjalor

mishtar, -i	butcher
bukëpjekës, -i	baker
çengel, -i, çengele, -t	hook
për të therur	to slaughter (animals); to stab; to prick
proshutë, -a	ham
salam, -i, salame, -t	salami
i prapëm, e prapme	rear; hind
furrxhi, -u	baker
shitëse, shitësja	salesgirl, saleslady
pastë, -a, pasta, -t	french pastry
revani, -a	cake
kremë, -a	icing; cream






Duke blerë gjëra ushqimi

0. Sot është ditë tregu dhe pasi gruaja ka punë në shtëpi, më përgatit një listë e më lutet që të vete e të blej harxhin. Si arrij në pazar nxjerr listën nga xhepi e mundohem të vendos se ç'të blej më parë. Filloj e blej ca ve e pastaj shoh në listë se pas veve vjen gjalpi, djathi, dhalla etj. Atëherë vete në një bulmetore
1. duke menduar se sa ushqime të shëndetshme bëjmë nga qumështi; me të bëjmë gjalpin, djathin, gjizën, kosin, dhallën etj.
2. Në bulmetore blej tre litra qumësht, dy litra dhallë, ca djathë etj.
3. Pastaj vete ke pemëshitësi e blej zarzavatet e pemët që gruaja ka shkruar në listë. Blej 1 kg. karota, 1 kg. qepë, patate, dardha, një pjepër etj.
4. Si mbaroj punë ke pemëshitësi shkoj në një dyqan gjërash ushqimi; është një dyqan vetëshërbimi. Blej ca kuti reçel, ca kuti salcë domatesh, sheqer, oriz, makarona etj.
5. Kur mbaroj së bleri gjërat që më nevojiten, marr karrocën e vogël të dorës dhe vete ke arkëtarin, i cili më llogarit me maqinën llogaritëse sa kam për të paguar.
6. Rrugës ndalohem për pak kohë përpara kambalecit të një shitësi ambulant çikërrimesh.

Fjalor

dhallë, -a	buttermilk
bulmetore, bulmetorja	dairy (store)
i shëndetshëm	healthful, wholesome; healthy
gjizë, -a	cottage cheese
litër, litri, litra, -t	liter
pemëshitës, -i	fruit and vegetable storekeeper
karotë, -a, karota, -t	carrot
vetëshërbim, -i	self-service
të blerë, -t	buying, purchasing
arkëtar, -i	cashier, teller, treasurer
për të llogaritur	to calculate; to compute; to figure (to reckon in figures); to count (to take into account)
maqinë llogaritëse	cash register
kambalec, -i	stand; sawhorse
çikërrime, -t	sundries





Në një dyqan veshmbathje dhe në këpucëtore






0. Vendos të blej një palë rroba e ca plaçka tjera për vete dhe shkoj në një dyqan veshmbathje. Si hyj në dyqan një nga shitësit më afrohet, më përshëndet dhe më pyet se ç'dëshiroj të blej. I them se ç'dua dhe së bashku vemi ku janë kostumet e pas pak kohe zgjedh një palë rroba të masës sime e të ngjyrës që dëshiroj.
1. Provoj kostumin dhe pasi më bie përgjithësisht mirë vendos t'a blej. Shitësi më merr masën dhe shënon ndreqjet që duhen bërë, si p.sh. gjatësinë e pantallonave, gjatësinë e mëngëve etj.
2. Pastaj vete në një repart tjetër të dyqanit ku blej një mushama dhe një çadër, pasi po afrohet stina e shirave.
3. Prej këtu shkoj në repartin ku shesin këpucë dhe blej një palë galloshe.
4. Të nesërmen shpie në këpucëtore dy palë këpucë për t'i ndrequr.
5. I tregoj këpucëtarit se ç'kanë nevojë këpucët: një palë duan gjysma (shojesh) dhe taka, kurse tjerat duan një palë taka të reja e kanë nevojë t'u qepen faqet se janë shkepur në disa vende.
6. Kur dal nga këpucëtorja ndalem ke një llustraxhi për të llustruar këpucët.

Fjalor

këpucëtore, këpucëtorja  
ndreqje, -a, ndreqje, -t

mushama, -ja  
galloshe, -t  
takë, -a, taka, -t  
për t'u-qepur  
faqe këpucësh  
për t'u-shkepur  
llustraxhi, -u  
për të llustruar

shoeshop, shoe repair shop  
repair; alteration; reconciliation;  
correction  
raincoat  
galoshes  
(shoe) heel  
to be sewn, stitched  
vamp, upper  
to be ripped (in the stitches)  
shoeshine boy or man  
to shine








## Nëpër dyqane të ndryshme

0. Vete në një dyqan hekurishtesh pasi kam nevojë të blejë ca vegla pune. Dyqanxhiu më tregon, duke bërë pak reklamë, çmimin e veglave të ndryshme. Blej një drapër për të prerë barin e keq që kam në fund të kopshtit, një sharrë dore dhe një shkallë. Paguaj e i them dyqanxhiut të m'i dërgojë plaçkat në shtëpi.
1. Pastaj vete në një dyqan mobiljesh e orendish të ndryshme për të parë çmimet e tregut pasi gruaja do të blejë disa plaçka për shtëpi.
2. Dyqanxhiu më shoqnon nëpër repartet e ndryshme të dyqanit duke më treguar çmimin dhe llojin e çdo artikulli. Kalojmë nëpër repartin e tryezave
3. e prej andej vemi në seksionin ku janë qilimat e hallitë. Hap disa prej tyre dhe më tregon çmimin e çdo qilimi e të çdo hallie.
4. Pastaj shkojmë në repartin ku janë sobat, radiatorët etj. Dyqanxhiu më tregon disa kuzina ekonomike (shporete), soba me dru, soba me qymyr guri, soba elektrike etj. Pas pak kohe falënderoj dyqanxhiun dhe dal.
5. Rrugës kaloj para një dyqani artikujsh sportivë dhe hyj brenda e pyes për çmimin e një kallami për të zënë peshk, pasi ai që kam tani është vjetëruar shumë.
6. Së fundi ndalem në sallonin e një përfaqësuesi automobilash për të parë modelet e reja të automobilave.

Fjalor

dyqan hekurishtesh	hardware store
dyqanxhi, -u	storekeeper
reklamë, -a, reklama, -t	advertisement, commercial
për të bërë reklamë	to advertise
drapër, -i	sickle
bar i keq, barëra të këqij	weeds
orendi, -të	(house, school, office) furniture
halli, -a, halli, -të	rug
sobë, -a	stove (heater)
radiator, -i, radiatorë, -t	radiator
shporet, -i	cooking stove
artikuj sportivë	sporting goods
kallam, -i	reed
kallam peshkimi	fishing rod
për t'u-vjetëruar	to get old, to age



Nëpër dyqane të ndryshme (vazhdim)

0. Vete në dyqanin e një pijeshitësi të blej një shishe raki e një shishe verë. Paguaj e në sa dal nga dyqani më bie në mend se një shok që s'e kam parë prej shumë kohe ka hapur një fabrikë të vogël vere në periferi të qytetit, dhe se më ka ftuar sa e sa herë që të vete të vizitohj fabrikën e tij. Kështu vendos të shkoj e t'a shoh po atë pasdreke.
1. Marr autobusin e vete t'i bëj vizitë. Si arrij në fabrikë gjej Skënderin, të cilit i bëhet qejfi që vajta t'a shoh. Më merr me vete e më shpie të vizitohj fabrikën. Shoh fuçitë e rrushit, shtrydhësit, kanistrat plot me rrush etj.
2. Pastaj vemi në qilar ku ndodhen fuçitë e mëdha plot verë e shishe me verëra të ndryshme. Skënderi më jep të kërkoj ca verë të re dhe unë e pyes se si vete tregëtia. Pasi rri një orë, ndahem prej tij dhe marr autobusin e kthehem në qytet.
3. Pasi zbres nga autobusi blej një akulllore nga një shitës ambulant dhe pastaj
4. vete në një farmaci për të blerë ca ilaçe me recetën që më dha mjeku kur dolla nga spitali.
5. Farmacisti më pregatit ilaçet dhe më tregon se sa herë në ditë e në ç'kohë të ditës duhet t'i pi.
6. Pasi është akoma heret për t'u-kthyer në shtëpi vete ke berberi të qethem, pasi gruaja ka një javë që më lutet të pres flokët.

Fjalor

pijeshitës, -i	keeper of a liquor store
në sa	while
i bëhet qejfi	he is pleased
shtrydhës, -i, shtrydhës, -it	wine press
qilar, -i	see "bodrum"
akulllore, akullorja	ice cream



## Pjesa I

I-1 Një mbrëmje vallëzimi dhe argëtimi.


I-2 Një zënkë në...familje.

I-3 Në bankë.

I-4 Në postë.

I-5 Telefon e telegraf.

I-1-0




I-1-1




I-1-2



I-1-3



I-1-4



I-1-5



I-1-6








Një mbrëmje vallëzimi dhe argëtimi

0. Zoti dhe zonja Kosova, me rastin e përvjetorit të martesës së tyre, na dërgojnë një ftesë për një mbrëmje vallëzimi dhe argëtimi. Pasi gruaja ka vajtur ke e ëma për një muaj, detyrohem të vete vetëm në festë. Si arrij në shtëpi të tyre, përshëndet zonjën dhe të zotin e shtëpisë dhe
1. vete në sallon ku marr një pije dhe njihem me të ftuarit. Në mes tyre është dhe një leshverdhë me të cilën njihem dhe bisedoj. Më tregon se është nëpunëse në Ministrinë e Financave dhe se është e pamartuar.
2. E ftoj të vallëzojmë dhe ajo pranon me kënaqësi. Zoti dhe zonja Kosova kanë marrë një orkestër për këtë mbrëmje.
3. Në një sallon tjetër të shtëpisë disa të ftuar janë duke lojtur me kartëra e disa tjerë duke lojtur shah.
4. Në një tryezë disa burra janë duke biseduar e kur zoti Kosova vete aty, njeri prej tyre i uron përvjetorin e ngrihet e mba një fjalim që s'mbaron kurrë.
5. Gjatë mbrëmjes takohem me disa miq të vjetër, të cilëve u tregoj disa shaka.
6. Në një kënd të sallonit një nga të ftuarit është i pirë e mezi qëndron në karrigë. Zoti Kosova i afrohet, e ngrë nga karriga dhe së bashku dalin nga salloni.

Fjalor

mbrëmje vallëzimi  
argëtim, -i  
i ftuar, -i, të ftuar, -it  
leshverdhë  
për të vallëzuar  
orkestër, orkestra  
për të lojtur  
kartëra  
i pirë

evening ball, dance night  
entertainment; amusement  
guest  
blond, blonde  
to dance  
orchestra  
see "për të luajtur"  
cards  
drunk









## Një zënkë në...familje

0. Mihali me të shoqen dalin për të shetitur. Duke ecur në trotuar u kalon pranë një grua e bukur, bile mund të them shumë e bukur. Mihali, të cilit i kanë pëlqyer dhe gjithnjë i pëlqejnë gjërat e bukura, i a ngul sytë bukuroshes kur ajo i kalon pranë. Edhe ajo e shikon Mihalin, por
1. në atë çast dëgjohet zëri i së shoqes, e cila i tërheq vrejten me zë të lartë për sjelljen e tij dhe vazhdon t'i bërtasë me të madhe. Atëhere Mihali mundohet t'i spiegojë se....
2. por, posa ai hap gojën për të folur, ajo i bie me shuplakë fytyrës. Njerëzit që kalojnë aty pranë çuditen nga kjo skenë e pavend xhelozie të marrë.
3. Më të nesërmen, pasi kjo s'është hera e parë që ngjet një gjë e tillë, Mihali vete ke avokati mbasi vendos të ndahet nga gruaja. Avokati merr të tëra informatat e nevojshme dhe i thotë se do të ngrehë padi për çkurorëzim.
4. Pas dy javësh hapet gjyqi e avokati kërkon nga gjyqtari që t'i japë divorc klientit të tij për arësyet që ai i parashton gjyqit.
5. Pastaj ngrihet avokati i anës së paditur dhe i përgjigjet padisë duke parashtuar gjendjen nga pikëpamja e klientit të tij.
6. Vjen radha të thirren dëshmitarët e njeri pas tjerit, pasi bëjnë betimin, dëshmojnë se ç'kanë parë e ç'kanë dëgjuar.

Fjalor

zënkë, -a	quarrel, argument
për të ngulur sytë	to stare
bukuroshe, bukuroshja	beauty
me të madhe	loud, loudly
i bie me shuplakë	she slaps him
skenë, -a	scene; stage
i, e pavend	out of place, inappropriate
xhelozia, -a	jealousy
i, e marrë	crazy, stupid
ngjet	see "ngjan"
avokat, -i	lawyer, attorney at law
për të ngrehur padi	to sue
padi, -a	lawsuit
çkurorëzim, -i	divorce
gjyqtar, -i	see "gjykatës"
divorc, -i	divorce






(Continued on p. 103)



0. Pas pak kohe që arrij në zyrë, shefi i seksionit më thërret e më lutet që të vete në bankë për të bërë disa veprime bankare për llogari të shoqërisë. Më thotë se ai nuk mund të largohet nga zyra pasi pret një klient me të cilin do të bisedojë formulimin e një kontrate furnizimi. Më jep udhëzimet e duhura dhe një çantë me para, çeqe etj. Arrij në bankë dhe vete në një sportel;
1. aty thyej disa bankënota 1,000 lekësh në bankënota më të vogla.
2. Pastaj vete në një tryezë ku plotësoj një formular duke rrjeshtuar në të numrin e çdo çeku dhe emrin e atij që e ka lëshuar dhe më në fund
3. çeqet i a dorëzoj nëpunësit të bankës për t'i depozituar në llogarinë e shoqërisë sonë. Nëpunësi kontrollon çeqet një nga një dhe më kërkon letërnjoftimin që më ka lëshuar shoqëria.
4. Pastaj derdh në llogari të shoqërisë edhe një shumë të hollash që nëpunësi i bankës shënon në librezën e bankës. Banka paguan një interes vjetor prej 4% për shumatat e depozituara.
5. Shoqëria jonë do të blejë me kredi një godinë për zyra. Vete të flas me nëpunësin e kredive bankare për të parë sa interes kërkon banka për një kredi të tillë. Ai më thotë se banka kërkon një interes vjetor prej 6% për huatë me skadim të gjatë.
6. Pastaj nëpunësi vete në kasafortën e bankës për të marrë regjistrin e llogarive të shoqërisë sonë.

Fjalor

shef, -i	chief
veprime bankare	bank transactions
formulim, -i	formulation
kontratë, -a	contract
për të rrjeshtuar	to line up; to assort
për të derdhur	to spill; to shed; to deposit (money)
librezë banke	bank book
i, e, të depozituar, të depozituara	deposited
kredi, -a	credit
me kredi	on credit
kredi bankare	bank credit, bank loan
hua me skadim të gjatë	long term loan
kasafortë	safe, vault, strongbox
<hr/>	
(Continued from I-2)	
klient, -i	client, customer
për të parashtruar	to submit; to present; to state
ana e paditur	defendant (side)
për të dëshmuar	to testify, to witness










Në postë

0. Vete në postë dhe i them nëpunësit që gjendet në sportel të më japë njëzet pulla. Ngjit dy prej tyre në letrën që kam për të nisur dhe e hedh në kuti. Në postë ka vende të ndryshme për të hedhur letrat që venë me postë të thjeshtë, letrat që venë me postë ajrore etj.
1. Kthehem në shtëpi dhe i shkruaj një letër gruas. Si mbaroj, shkruaj adresën, fut letrën në zarf
2. dhe e mbyll. Marr edhe dy letra tjera e një kartëpostale që kam shkruar më parë dhe
3. vete e i hedh në kutinë e postës mbi të cilën është shënuar orari i mbledhjes së letrave. Pastaj kthehem në postë e
4. vete në sportelin e pakove që të nis një kolipostë dhe një letër, e cila më duket se është më e rëndë se ç'lypset. Nëpunësi pasi e peshon më thotë se ka nevojë dhe për dy pulla tjera. Peshon dhe kolipostën.
5. Pastaj i them të më bëjë një mandapostë. Paguaj, falënderoj nëpunësin dhe kthehem në shtëpi.
6. Posa arrij para shtëpisë takoj postierin, i cili më thotë se kam një letër të porositur. Pasi marr letrën nënshkruaj për marrjen e saj.

Fjalor

për të hedhur  
postier, -i  
marrje, -a

see "me hjedhë"  
mailman  
receiving





Telefon e telegraf

0. Një nga vendet ku puna vazhdon pa ndërprerje, natë e ditë, për shtatë ditët e javës është centrali i telefonit. Centralistët e centralistet punojnë në turne të ndryshme: ca vinë e ca shkojnë gjatë njëzet e katër orëve të ditës.
1. Kur dua të telefonoj vete në një kabinë telefoni, pasi unë s'kam telefon në shtëpi. Aty zakonisht ka edhe një libër të telefonave, në të cilin gjenden emrat dhe numrat e telefonit të të gjithë atyre që kanë telefon.
2. Përdorimi i telefonit është fare i lehtë. Së pari ngre dorëzën e telefonit, pastaj fut në vendin e posaçëm një lek dhe së fundi bëj numrin e telefonit të atij që dua të thërres e
3. pasi mbaroj bërjen e numrit dëgjoj duke rënë zilja e telefonit që kam thirrur.
4. Telegrafi punon ndryshe. Për të dërguar një telegram duhet të shkoj në zyrën e telegrafit; atje shkruaj telegramin në një formular dhe i a ap telegrafistit, i cili e transmeton me anë të aparatit telegrafik.
5. Kur arrin në zyrën marrëse i jepet një përdasi, i cili e shpie në adresën e duhur.
6. Disa telegrame rezervate dërgohen me shifër, kështu vetëm dërguesi dhe marrësi e marrin vesh.

Fjalor

central telefoni	telephone exchange
centralist, -i	telephone operator
centraliste, centralistja	telephone operator
turn, -i, turne, -t	shift
dorëz telefoni	telephone receiver
telegram, -i	telegram
telegrafist, -i	telegraph operator
marrës, -e	receiving
rezervat, -e	confidential
shifër, shifra	code; figure; digit; statistics



## Pjesa J




J-1 Jeta në fshat në prëndverë.

J-2 Jeta në fshat në prëndverë (vazhdim).

J-3 Vera në fshat.

J-4 Vjeshta në fshat.

J-5 Dimri në fshat.





J-1

Jeta në fshat në prëndverë

0. Jam në kooperativën bujqësore të një fshati. Pranë ndërtesave qendrore të kooperativës shihen karro e kamiona që sjellin e shpien farëra, plehra, vegla pune etj. Stina e shirave ka kaluar dhe vijat kulluese i kanë bërë fushat gati për plugim. Të gjithë anëtarët e kooperativës janë duke punuar:
1. ata që kujdesen për mirëmbajtjen e shtallave fillojnë t'i rregullojnë, t'i meremetojnë e t'i lyejnë. Ata që kujdesen për gjënë e gjallë e për kafshët tjera i nxjerrin këto nga shtallat, i kashaisin, u hedhin ushqim ose
2. i çojnë t'u japin ujë ke pompa ose ke lugu.
3. Në fusha në këtë ndërkohë valon puna. Rreth e përçark dëgjohet zhurma e traktorëve që plugojnë arat e aty-këtu shihet ndonjë parmendë e tërhequr nga një pendë qe.
4. Më tutje shoh disa kooperativistë duke mbjellur e duke trinuar.
5. Në orizore anëtarët e kooperativës rregullojnë vadat, kështu që të mos jecin pa ujë.
6. Në kodrina e në pemishte shihen fshatarët duke hapur gropa, duke mbjellur fidane e duke krasitur.

Fjalor

karro, -ja	cart, wagon
farë, -a, farëra, -t	seed
vija kulluese	draining system
plugim, -i	ploughing
për të meremetuar	to repair
gjë e gjallë	cattle, livestock
për të kashaisur	to curry
pompë, -a	pump
lug, -u	water trough
valon puna	the activity is at its peak
për të pluguar	to plough, till
ka, -u, qe, -të	ox
një pendë qe	a yoke of oxen
kooperativist, -i	
kooperativistë, -t	a member of a cooperative
për të trinuar	to harrow
orizore, orizorja, orizore, -t	rice paddy
vadë, -a, vada, -t	irrigation system
fidan, -i, fidane, -t	shoot; sapling
për të krasitur	to prune





Jeta në fshat në prëndverë (vazhdim)

0. Prëndvera është stina e gjelbërimit dhe stina e luleve. Kudo, si në fusha ashtu në parqet e qyteteve pemët fillojnë të mbulohen me lule, zogjtë ndërtojnë foletë e tyre e dielli shkëlqen mbi barin e njomë.
1. Barinj të nxjerrin kopetë e tyre nga stanet e i shpien për të kullotur ndër livadhe e kodrina.
2. Në prëndverë disa bujq fillojnë edhe rritjen e bletëve. Ndërtojnë zgjoj e kujdesen për mirëmbajtjen e tyre, kështu që të marrin sa më shumë mjaltë.
3. Aty-këtu nga shkrrirja e dëborës shkaktohen shembje dhe zihen rrugët, por punëtorët e punëve botore i hapin me të shpejtë, kështu që të mos ketë pengime për mjetet e komunikacionit.
4. Bujqtë mbjellin barishtet në këtë kohë, si p.sh. sallatë, pras, qepë etj. dhe ndërtojnë aty pranë ndonjë dordolec, kështu që zogjtë të mos hanë farën e porsambjellur.
5. Të tjerë prashitin e qërojnë vendin nga barërat e këqij, u hedhin pleh bimëve të porsadalura dhe i ujisin.
6. Prëndvera është edhe koha kur kooperativistët spërkasin pemët që t'i mbrojnë këto nga insektet e dëmshme e nga sëmundjet.

Fjalor

gjelbërim, -i	see "blerim"
fole, -ja, fole, -të	nest
kope, -ja, kope, -të	herd, flock
stan, -i, stane, -t	a shepherd's hut; stable
shkrrirje, -a	melting
dëborë, -a	see "borë"
shembje, -a, shembje, -t	landslide
punë botore	public works
pras, -i	leek
dordolec, -i	scarecrow
i, e porsambjellur	just planted, newly planted
për të prashitur	to hoe, to rake over
të porsadalura	just sprouted
për të spërkatur	to sprinkle
i dëmshëm, e dëmshme	harmful





## Vera në fshat

0. Në verë fusha merr një ngjyrë tjetër. Gjelbërimi i prëndverës zëvendësohet me ngjyrën e florinjte dhe fushat duken sikur janë prej kadifeje. Të lashtat janë gati të korren dhe një ditë prej ditësh fushat mbushen plot njerëz dhe
1. puna nuk pushon ditë e natë derisa të mos jetë korrur kalli i fundit, kështu që bereqeti të mos rrezikohet nga një shi i papritur. Maqina korrëse, traktorë, kosa e drapëre lëvizin pa pushuar ditën nën diellin përcëllonjës e natën në dritën e automjeteve e të llambave ndriçonjës.
2. Bari i thatë, pasi është kositur, ngarkohet ndër qerre e dërgohet në vende ku e mbledhin në mullarë.
3. Edhe gruri, pasi korret, mbledhet në duaj, të cilët pastaj ngarkohen ndër karro e dërgohen në kooperativë ku
4. ja shihet me dorë, ja me anë të kuajve në lëmë ose
5. me maqinë. Pasi xhvishet gruri nga kallëzit futet ndër thasë dhe
6. dërgohet në mulli ku bluhet e bëhet miell. Gjejmë, sipas vendit, edhe mullinj të ndryshëm. Kemi mullinj me erë, mullinj me ujë e mullinj me motor.

Fjalor

për t'u-zëvendësuar  
i, e florinjte  
për t'u-korrur  
kali, -u





to be replaced  
golden, gold  
to be harvested  
corn cob; an ear of corn or  
wheat

për t'u-rrezikuar  
maqinë korrëse  
kosë, -a, kosa, -t  
përcëllonjës, -e  
ndriçonjës, -e  
për t'u-kositur  
qerre, qerrja, qerre, -t  
mullar, -i, mullarë, -t  
duaj, -t  
për t'u-shirë  
lëmë, -i

to be endangered, jeopardized  
harvester, reaper  
scythe  
scorching  
illuminating  
to be mowed  
cart  
haystack  
sheaves (of wheat)  
to be threshed  
threshing floor; field (of  
activity)

pasi xhvishet gruri  
kallëz, -it  
mulli, -ri, mullinj, -të  
për t'u-bluar

after the wheat is threshed  
ears of wheat, corn, etc.  
flour mill  
to be ground; to be digested








## Vjeshta në fshat

0. Qëllon që në vjeshtë, nga shirate mëdhenj, rrugët të për-  
mbyten e natyrisht në këtë rast vijat e komunikacionit  
priten. Kur ngjan një gjë e tillë rrugët e fshatit mbulohen  
me baltë e shumë herë automobilat e kamionat ngecin, d.m.th.  
s'mund të lëvizin. Atëherë banorët e fshatit dalin e u  
ndihmojnë shoferave t'i nxjerrin automjetet nga balta.
1. Nganjëherë edhe lumenjtë dalin nga shtretërit e tyre dyke  
thyer cfratet, kështu që përmytin fushat e fshatrat. Në  
këtë rast të gjithë banorët mobilizohen që të mbyllin  
cfratet me thasë me rërë ose me dhe që të ndalojnë dëmet e  
mëdha që shkakton përmytja.
2. Kur nuk i pengon koha e keqe, banorët e fshatit merren me  
punët e zakonshme të stinës. Disa presin lëndë në pyll,
3. disa plehërojnë arat duke përgatitur tokën për mbjellje dhe
4. ndonjë vete për gjah pasi vjeshta është stina e gjahut. Në  
këtë stinë është e lejueshme të vrasësh shumë lloje kafshësh  
dhe shpendsh, si p.sh. lepura, derra të egjër, thëllëza,  
pëllumba të egjër etj.,
5. kurse nallbani vazhdon në punën e tij të zakonshme duke  
mbathur kafshët.
6. Në vjeshtë, nga stuhitë e shpeshta, dëmtohet edhe ndonjë  
shtëpi. Qëllon edhe që nga rrufetë të marrë zjarr ndonjë  
godinë e atëherë është detyra e zjarrfikësve dhe e gjithë  
banorëve që të përpiqen t'a shuajnë.

Fjalor

për t'u-përmytur	to be flooded, inundated
për të ngecur	to get stuck, to bog down
cfrat, -i, cfrate, -t	dike
për të përmytur	to flood, inundate
për t'u-mobilizuar	to be mobilized
përmytje, -a	flood, inundation; deluge
për të plehëruar	to fertilize
mbjellje, -a	planting
thëllëzë, -a, thëllëza, -t	see "fëllanxë"
pëllumb, -i, pëllumba, -t	pigeon; dove
nallban, -i	farrier
stuhi, -a, stuhi, -të	storm



Dimri në fshat

0. Pa ardhur edhe mirë dimri shiu bie më rrallë ose nuk bie më dhe vendin e tij e zë dëborë. Të gjitha pullazet, rrugët dhe fushat janë të mbuluara me dëborë. Fshatarët shihen rrallë përjashta e vetëm fëmijët luajnë nëpër rrugët e zbardhura e bëjnë njerëz me dëborë.
1. Kur vjen dimri dëborë pothuajse nuk pushon që rëni. Shumë herë qëllon që bie kaq shumë dëborë sa që është e nevojshme të pastrohen pullazet e oborret me lopatë e rrugët ja me traktorë ja me buldozerë.
2. Kur qëllon që del ndonjë ditë e bukur shumë veta venë në kodrinat pranë fshatit e shkasin me ski e me saja. Disa fshatarë tjerë
3. venë mbi liqen të ngrirë e shkasin mbi akull. Të tjerë hapin vrima në akullin e liqenit nëpër të cilat zënë peshk.
4. Nganjëherë, për të vajtur gjëkund, njerëzit duhet të dalin edhe në tufan, por kjo është një gjë e rrezikshme pasi njeriu nuk sheh dot nga dëborë dhe era është kaq e fortë sa që shumë herë të rrëzon përdhe.
5. Nga shkaku i dëborës së madhe mjetet me rrota nuk udhëtojnë dot e vetëm mjetet me zinxhirë e sajat shihen aty-këtu.
6. Nëpër shtëpi njerëzit rrinë pranë oxhakut, ku zjarri nganjëherë nuk shuhet muaj me radhë.

Fjalor

edhe	see "ende"
pullaz, -i, pullaze, -t	see "çati"
e zbardhura	whitened; white-headed
buldozer, -i, buldozerë, -t	bulldozer
sajë, -a, saja, -t	sleigh; sled
për të rrëzuar	to knock down, to fell; to topple
zinxhir, -i, zinxhirë, -t	chain
muaj me radhë	(for) months in a row



Pjesa K







K-1 Vjedhje e vrasje.

K-2 Policia kap kriminelët.

K-3 Në vendin e aksidentit.

K-4 Hetime nga ana e policisë dhe burgosja e kriminelëve.

K-5 Dënimi i fajtorëve.











## Vjedhje e vrasje

0. Tre hajdutë vendosin të venë të grabisin një shtëpi. Njeri prej tyre, duke ditur se në shtëpi banon një grua vetëm, ka përgatitur planin. Venë përpara shtëpisë e futen në oborr duke kapërcyer murin. Njeri nga hajdutët, që të mos njihet, ka mbuluar sytë me një maskë; i dyti ka një shami që i mbulon gjysmën e fytyrës, kurse i treti ka fytyrën të zbuluar.
1. Si futen në oborr, pa bërë potere, thyejnë portën e shtëpisë, u ngjiten shkallëve dhe venë para portës së dhomës së gjumit, por nuk futen dot brenda pasi është kyçur. Atëhere njeri nga hajdutët e hap me një çelës fals.
2. Kur çelet porta, zonja e shtëpisë zgjohet dhe menjëherë një nga hajdutët i ve dorën mbi gojë që të mos bërtasë, ndërsa tjetri merr çdo gjë me vleftë që gjen në dhomë.
3. Papritmas zonja i a largon dorën nga goja dhe lëshon një britmë. Atëhere hajduti, duke humbur gjakftohtësinë, i bie në kokë dy a tri herë me topuzin që ka në dorë dhe i shkakton vdekjen.
4. Pas kësaj tre hajdutët dalin me vrap nga shtëpia. Vjedhin një automobil, pasi thyejnë xhamin e dritares për të hapur dërrën, dhe largohen me të shpejtë prej andej. Mirëpo një njeri duke kaluar rrugës e ka parë ngjarjen e fundit.
5. Pas pak kohe automobilit i çpohet një gomë, kështu që hajdutët detyrohen të ndalen. Ngrejnë automobilin me krik dhe ndërrojnë gomën e çpuar me gomën rezervë dhe
6. vazhdojnë ikjen që të largohen sa më shumë e më shpejt nga vendi i krimit. Ndalohen vetëm tek një pompë benzine për të blerë benzinë.

Fjalor

hajdut, -i, hajdutë, -t  
 potere, poterja  
 për t'u-kyçur  
 fals, -e  
 britmë, -a  
 topuz, -i  
 për t'u-çpuar  
 i çpohet një gomë  
 krik, -u  
 i, e çpuar  
 ikje, -a

thief; robber  
 see "zhurmë"  
 to be locked  
 false; phony; fake; counterfeit  
 scream; shout, shouting  
 club  
 to be pierced, bored; to be deflated  
 it has a flat tire  
 jack  
 flat (for tire); pierced, bored  
 escape, flight



Policia kap kriminelët







0. Sikur u-tha më parë, një njeri që po kalonte rrugës pa hajdutët duke vjedhur automobilin dhe menjëherë lajmëroi me telefon zyrën qendrore të policisë. I tregoi se sa hajdutë ishin, si ishin të veshur, numrin e targës së automobilit që vodhën, ç'lloj automobili ishte dhe se në ç'drejtim vajtën.
1. Pas këtyre informatave zyra qendrore e policisë lajmëron me radio një nga automobilat-patrullë të policisë që të vihet menjëherë në ndjekje të kriminelëve. Pas një gjysmë ore patrulla lajmëron qendrën se ka zbuluar automobilin e hajdutëve dhe se është duke e ndjekur.
2. Hajdutët kur shohin se maqina e policisë është duke i ndjekur fillojnë t'a ngasin automobilin më shpejt dhe gjatë ikjes shkelin për vdekje një këmbësor.
3. Në këtë ndërkohë maqina e policisë i është afruar shumë automobilit të hajdutëve. Policët fillojnë të shtien kundër kriminelëve, por edhe këta të fundit shtien kundër policëve.
4. Disa plumba qëllojnë automobilin e hajdutëve; shoferi humb kontrollin e përplasat me një automobil tjetër.
5. Në atë kohë automobili i policisë arrin në vendin e aksidentit e thërret me radio një autoambulancë. Pastaj policët ndalin maqinën, dalin prej saj dhe arrestojnë dy nga kriminelët kurse i treti, shoferi, është plagosur rëndë.
6. Si arrin autoambulanca, infermierët ngarkojnë të plagosurit në të dhe i shpien në spital. Bashkë me të plagosurit vete edhe një polic për të ruajtur kriminelin. Patrulla e policisë me kriminelët tjerë presin policinë e qytetit më të afërm dhe policinë rrugore për të hetuar aksidentin.

Fjalor

targë, -a  
për t'u-vënë në ndjekje  
ndjekje, -a

kriminel, -i, kriminelë, -t  
për vdekje  
polici rrugore  
për të hetuar

license plate  
to chase, pursue  
chase, pursuit; prosecution;  
attending  
a criminal, a felon  
mortally  
highway patrol  
to investigate








Në vendin e aksidentit

0. Pasi u-nisën të plagosurit me autoambulancë, policia çarmatos kriminelët dhe merr masa që të mos ndalet trafiku nga aksidenti megjithëqë disa automobila mundohen të ndalen, jo shumë larg prej aty, për të parë se ç'ka ngjarë.
1. Policët, pasi u marrin armët kriminelëve, u venë prangat ndër duar dhe
2. i fusin në kamionin e veçantë që policia ka sjellë nga qyteti i afërm dhe i nisin për në burg.
3. Një nëpunës i policisë rrugore merr disa fotografi të të dy automobilave të shkatërruar nga aksidenti,
4. kurse disa policë tjerë masin largësinë që po udhëtonin automobilat nga buza e rrugës para se të ngjante aksidenti, dhe vendin ekzakt në rrugë ku ka ngjarë aksidenti. Mbajnë gjithashtu një proces-verbal.
5. Në automobilin e kriminelëve policia gjeti plaçkat e vjedhura në shtëpinë ku njeri nga hajdutët mbyti me topuz zonjën e shtëpisë.
6. Pasi mbaron çdo punë në vendin e aksidentit një kamion i vogël me vinç tërheq maqinat e shkatërruara dhe i shpie në një vend ku smontohen e pastaj përdoren për hekurina.

Fjalor

për të çarmatosur	to disarm
pranga, -t	handcuffs
ekzakt, -e	exact
i, e, të vjedhur, të vjedhura	stolen
për t'u-smontuar	to be disassembled,
	to be taken apart
hekurina, -t	scrap iron







Hetime nga ana e policisë dhe burgosja e kriminelëve

0. Si u-sollën kriminelët në qytetin ku bënë krimin e shëmtuar, policia i merr në pyetje herë pas here, kështu që të përcaktojnë me siguri se cili prej tyre ka bërë krimin dhe se si është zhvilluar vjedhja. Pas shumë pyetjeve të gjata ai që bëri vrasjen rrëfeu dhe pranoi krimin.
1. Në këtë ndërkohë disa policë të seksionit të veçantë të hetimeve venë në shtëpinë ku qenë hajdutët e ku mbytën zonjën e shtëpisë, që të mbledhin të gjitha provat e krimit.
2. Pastaj në zyrë krahasojnë gjurmët e gishtërinjve të lëna nga kriminelët në shtëpinë ku bënë krimin me gjurmët që gjenden në dosjen e përgjithshme që ka policia, dhe zbuluan se disa nga gjurmët e gjetura në shtëpi ishin të njëjta me ato që gjendeshin në polici.
3. Në këtë kohë një nga hajdutët është i veçuar në një birucë të burgut dhe
4. një natë me anë të një sharre të vogël (nuk u-muar kurrë vesh se ku e kish marrë) sharron hekurat e dritares së vogël dhe
5. duke grisur bataniet e duke bërë me copat e grisura një farë lloj litari mundohet të ikë nga dritarja. Porsa fillon të zbresë një rojë e zbulon; e kap dhe e fut në një birucë tjetër të burgut.
6. I dëshpëruar që s'mundi të ikë dot dhe meqë s'mund t'a duronte jetën në burg, i burgosuri gjatë natës vari veten. Nesërejt një nga rojet e burgut duke bërë inspektim, e gjeti të varur.

Fjalor

burgosje, -a  
i, e shëmtuar  
për të krahasuar  
gjurmët e gishtërinjve  
të lëna  
e gjetura  
i, e veçuar  
birucë, -a  
për të sharruar  
hekura, -t  
për të grisur  
i, e dëshpëruar  
i burgosur, -i  
inspektim, -i  
i, e, të varur

imprisonment  
ugly  
to compare  
the fingerprints  
left; sloppy  
found  
isolated  
prison cell; small hole  
to saw  
bars (of window)  
to tear; to rip  
desperate; depressed  
prisoner  
inspection  
hanged, hung





## Dënimi i fajtorëve

0. Pas vdekjes së njerit nga hajdutët, dy tjerët u-sollën para gjyqit dhe në përfundim njeri u-dënua me pesëmbëdhjetë vjet burgim të rëndë kurse tjetri, vrasësi, mori dënim me vdekje. Ai që u-dënua me burgim të rëndë u-dërgua në qendrën e punës ku punojnë të burgosurit, kurse i dënuari me vdekje u-suall në burg për të pritur ekzekutimin.
1. Natën para ekzekutimit, familja e të dënuarit -gruaja dhe djali -venë t'a vizitojnë për herën e fundit.
2. Pastaj prifti i burgut vete t'a shohë e t'a ngushullojë.
3. Gjatë natës, në gjumë, të dënuarit i duket në ëndër gruaja që ka vrrarë; sheh edhe ëndra tjera të frikshme.
4. Nesërejt heret në mëngjes e marrin të dënuarin dhe e shpien në dhomën ku gjendet karriga elektrike. Pasi e ulin dhe e lidhin në të e ekzekutojnë.
5. Atë pasdreke zhvillohet funerali (salikimi). Familjarët, fisi e miqtë e të vdekurit e përcjellin arkivolin gjer në vorreza ku
6. e varrosin duke i dhënë përshëndetjen e fundit. Kështu, kur lopata e fundit me dhe mbulon arkivolin, mbyllet kapitulli i fundit i një njeriu që pagoi me jetë krimin e tij duke i marrë jetën një tjetri.

Fjalor

fajtor, -i, fajtorë, -t	the guilty (one); culprit
burgim të rëndë	hard labor (imprisonment)
i dënuar, -i	the condemned; a convict
prift, -i	priest
për të ngushulluar	to console; to comfort;
	to offer condolences
për të parë ëndër	to dream
për të ëndëruar	to dream
funeral, -i	funeral
salikim, -i	funeral
familjarë, -t	members of one's family
fis, -i	kinship; clan; tribe
për të varrosur	to bury
përshëndetje, -a	salute; greeting
kapitull, -i	chapter

